



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 462 Akti

Nr. 386 Vendimi  
Tiranë, më 18.5.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Lulzim Hamitaj</b>	Kryesues
<b>Alma Faskaj</b>	Relatore
<b>Genta Tafa ( Bungo)</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në datën 18.5.2021, ora 09:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket,

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Avni Kraja**, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Avni Kraja, me funksion prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

3. Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (në vijim ILDKPKI) ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Avni Kraja, duke krahasuar: deklaratën e pasurisë *Vetting*; deklaratat e pasurisë në vite; si dhe dokumentacionin justifikues bankar, jobankar etj., të dorëzuar nga subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve publike. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja konstaton se për subjektin e rivlerësimit, z. Avni Kraja:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

4. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 19.12.2019, të trupit gjykues nr. 2, pas studimit të raportit të vlerësimit të pasurisë, të hartuar nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 për një kriter, bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht vlerësimin e pasurisë. Me mirëkuptim u caktua kryesues i trupit gjykues, komisioner Lulzim Hamitaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 14.4.2020 subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi përbërjen e trupit gjykues, për të cilin në datën 15.4.2020 deklaroi, përmes postës elektronike, se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Në datën 11.3.2021 trupi gjykues, me vendimin nr. 2, vendosi: të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Avni Kraja, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes vetëm për kriterin e pasurisë.

7. Në datën 16.3.2021 trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të paraqesë pretendime/sqarime shtesë brenda datës 31.3.2021, për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

8. Në datën 31.3.2021 subjekti i rivlerësimit paraqiti një kërkesë për përfshirjen në procesin e rivlerësimit edhe të kriterit profesional, si dhe për rihapjen e hetimit.

9. Në datën 10.4.2021 subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit kryesisht.

10. Trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Avni Kraja, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti, me anë të postës elektronike, u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 16.4.2021, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

11. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 12.4.2021. Kjo seancë nuk u zhvillua për shkak se me njoftimin me *e-mail* të datës 15.4.2021 subjekti kërkoi shtyrje të seancës dëgjimore me 7 ditë kalendarike, për shkak se ishte me raport mjekësor. Subjekti vuri në dispozicion të Komisionit me *e-mail*, raportin nr. \*\*\*, datë 15.4.2021, për paaftësi të përkohshme në punë.

12. Subjekti i rivlerësimit u njoftua elektronikisht me *e-mail*-in e datës 16.4.2021, për pranimin e kërkesës dhe shtyrje të seancës dëgjimore në datën 26.4.2021, ora 09:30.

13. Subjekti, me *e-mail*-in e datës 22.4.2021, kërkoi shtyrje të seancës dëgjimore, referuar gjendjes së tij shëndetësore, e cila sipas pretendimeve të tij ishte e njëjtë dhe bashkëlidh raportin nr. \*\*\*, datë 22.4.2021, për paaftësi të përkohshme në punë.

14. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail* në datën 30.4.2021, ora 09:30.

15. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit filloi në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 30.4.2021, ora 09:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.

16. Subjekti u përfaqësua në seancë me përfaqësuesen ligjore, av. Irena Reso, me prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 29.4.2021. Pas rifillimit të seancës dëgjimore, përfaqësuesja e subjektit të rivlerësimit parashtrroi një kërkesë paraprake për shtyrje të seancës dëgjimore, pasi ajo kërkoi kohë të arsyeshme për t'u përgatitur për të përfaqësuar subjektin. Trupi gjykues u tërhoq për vendim dhe vendosi të ricaktojë seancën dëgjimore në datën 6.5.2021, ora 12:00.

**17.** Seanca dëgjimore e datës 6.5.2021, ora 12:00, filloi me një kërkesë paraprake të subjektit të rivlerësimit. Ai kërkoi përjashtimin e relatores së çështjes, komisionere Alma Faskaj, nga trupi gjykues për gjykimin e tij. Trupi gjykues u tërhoq për vendim dhe vendosi të përcjellë pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit kërkesën me qëllim ngritjen e një tjetër trupi gjykues për shqyrtimin e kërkesës në fjalë dhe njoftoi datën e seancës së radhës dëgjimore, 7.5.2021, ora 09:30.

**18.** Seanca dëgjimore rifilloi në datën 7.5.2021, ora 09:30. Kryesuesi i seancës relatoi mospranimin e kërkesës për përjashtim të relatores së çështjes, komisionere Alma Faskaj, dhe vazhdimin e seancës dëgjimore.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**19.** Z. Avni Kraja nuk ka qenë plotësisht bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit të kryer ndaj tij, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Subjekti ka kërkuar gjatë procesit shtyrje të afatit të përgjigjeve, pa argumentuar shkaqet e këtyre kërkesave. Gjatë seancës dëgjimore ka depozituar kërkesa paraprake procedurale, me qëllim zvarritjen e vijimit të procesit të rivlerësimit.

### **IV. KËRKESAT E SUBJEKTIT DHE VLERËSIMI I TYRE**

**20.** Gjatë procesit të zhvillimit të hetimit administrativ, si dhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka paraqitur disa kërkesa.

#### **20.1 Kërkesat përpara zhvillimit të seancës dëgjimore**

**20.1.1** Pas kalimit të barrës së provës dhe njohjen me rezultatet e hetimit, në datën 16.3.2021, subjekti ka dërguar me anë të postës elektronike kërkesën e datës 29.3.2021, nëpërmjet së cilës ka kërkuar shtyrje të afatit të dorëzimit të prapësimeve për një periudhë 10-ditore. Subjekti ka parashtruar si shkak të kërkesës për shtyrje faktin se ka qenë në pritje të përgjigjeve për të siguruar dokumentacion ligjor për t’i paraqitur si provë për kërkesat që i kishte drejtuar DPT-së për ligjshmërinë e të ardhurave të realizuara nga shitja e të drejtës reale, nënshkrimi i aneks kontratës me grupin e investitorëve për të paraqitur dokumentacion ligjor që vlera përfundimtare e blerjes së apartamentit është 105,000 euro, “Tirana Bank” për pagesën në shumën 15,000 euro për konfirmimin e urdhëruesit të pagesës nga bashkëshortja, sigurimi i dokumentacionit në Lushnjë për arkëtimin e shumës së parave përpara datës së nënshkrimit të kontratës, vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore për pagesën e kontributeve të bashkëshortes, si dhe dokumente të tjera të nevojshme për dhënien e shpjegimeve.

**20.1.2** Në mbledhjen e datës 31.3.2021, trupi gjykues vendosi mospranimin e kërkesës së subjektit për shtyrje të afatit, në mungesë të dërgimit të provave se nga ana e tij ishin bërë përpjekje për t’i administruar këto prova brenda afati të përcaktuar nga trupi gjykues i Komisionit.

**20.1.3** Në datë 31.3.2021 subjekti paraqiti në Komision një kërkesë për riçelje të hetimit administrativ të procesit të rivlerësimit, duke kërkuar të shtrihet edhe në kriteret e kontrollit të

figurës dhe aftësive profesionale, si dhe marrjen e ekspertëve vlerësues të pasurive të paluajtshme dhe ekspertëve teknikë të ndërtimit (preventivues) të licencuar në lidhje me objektin e banimit apartament, kati i 3-të, në rrugën “\*\*\*”.

**20.1.4** Në mbledhjen e datës 6.4.2021, të zhvilluar *online*, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesat e subjektit për marrjen e provave mbështetëse vendosi se:

i) Lidhur me kërkesën e parë, Komisioni çmoi se subjekti kishte të drejtë të paraqiste prova dhe shpjegime në lidhje me barrën e provës. Komisioni i bëri me dije subjektit se këto prova dhe shpjegime, të dhëna edhe gjatë seancës dëgjimore, do të vlerësohen edhe në raport me rihapjen ose jo të hetimit, duke respektuar të gjitha të drejtat e subjektit.

ii) Lidhur me kërkesën për rihapje të hetimit edhe për dy kriteret e tjera, kriterin profesional dhe atë të figurës, Komisioni vendosi se në bazë të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 në gjendjen që ish-in aktet, procesi i rivlerësimit të subjektit duhet të vijonte vetëm me kriterin e pasurisë.

iii) Lidhur me kërkesën për marrjen e një eksperti, Komisioni vendosi se marrja e tij është e panevojshme, në përputhje me germën “a”, të nenit 49/6, të ligjit nr. 84/2016. Subjektit iu bë me dije se nëse ai kishte marrë një ekspert mund ta depozitonte aktin e tij pranë Komisionit për t’u vlerësuar. Subjekti u informua gjithashtu se nuk kishte vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacion lidhur me kërkesat që kishte përcjellë pranë institucioneve, për shkak të të cilave kishte kërkuar më shumë kohë.

Në përfundim, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, të datës 1.4.2021, vendosi refuzimin e kërkesave të subjektit, duke e njoftuar se në çdo rast trupi gjykues do të administrojë çdo provë të paraqitur nga subjekti në përgjigje të barrës së provës ose gjatë seancës dëgjimore, duke respektuar të gjitha të drejtat e subjektit.

Dispozitivi i këtij vendimi iu njoftua menjëherë subjektit me anë të *e-mail*-it të datës 6.4.2021. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, iu dërgua subjektit me anë të shërbimit postar, me shkresën përcjellëse nr. \*\*\*prot., datë 6.4.2021.

## **20.2** Kërkesat gjatë seancës dëgjimore

**20.2.1** Seanca dëgjimore filloi sipas njoftimit të bërë në datën 30.4.2021, ora 09:30, ku subjekti nuk u paraqit, por u paraqit përfaqësuesja e tij ligjor, znj. Irena Reso, me prokurën nr. \*\*\*, datë 29.4.2021, para noterit E. K. .

Menjëherë me legjitimimin e trupit gjykues në nisje të seancës, përfaqësuesja ligjore kërkoi fjalën, duke deklaruar: *“Kam një kërkesë paraprake, është në rrethanat e mbrojtjes dinjitoze të atij që kam marrë përsipër të mbroj. Ju e vutë re, pasi e këqyrët vetë që prokura ishte e datës së djeshme dhe më duhet kohë e arsyeshme që të unë të vij të përfaqësoj si duhet atë që kam marrë përsipër të përfaqësoj”*.

Menjëherë pas kësaj kërkesë të paraqitur nëpërmjet deklaramentit në seancë të përfaqësueses së subjektit, trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore dhe u tërhoq për marrje vendimi. Komisioni

vendosi pranimin e kërkesës së përfaqësueses ligjore dhe shtyrjen e seancës dëgjimore në datën 6.5.2021, ora 12:00.

**20.2.2** Në seancën dëgjimore të datës 6.5.2021, ora 12:00, menjëherë pas fillimit të seancës subjekti kërkoi përjashtimin e relatores së çështjes, komisionere Alma Faskaj, duke deklaruar se: *“Para disa ditësh kam kuptuar se relatorja e procesit të rivlerësimit tim, znj. Faskaj, është i njëjti person me një gjyqtare Alma Vokopola, e cila në vitet që unë kam qenë prokuror në Rrethin e Lushnjës zonja në fjalë ka qenë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, flas për vitin 1996. Po kështu, kam rënë në dijeni të fakteve të bëra publike në portale se për sa i takon vendimit ai është me nr. 8, datë 23.8.1996, i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe është liruar nga detyra me motivacionin për shkelje të ligjit për paaftësi. Po kështu, ka edhe dy kallëzime penale, të cilat në dijeninë time janë në proces në gjykatë. Zonja që është ulur në atë karrige ku po më gjykon sot dhe vetëm se ka treguar këtë fakt i cili është kriter skualifikues, sipas ligjit nr. 84/2016. Zonja është caktuar në këtë detyrë dhe vazhdon të jetë për mendimin tim në kushtet e papajtueshmërisë, sipas parashikimeve të nenit 16 të ligjit nr. 84/2016. Në këto rrethana kërkoj përjashtimin nga trupi gjykues i znj. Alma Faskaj”.*

**20.2.3** Menjëherë pas kësaj kërkesë të paraqitur nëpërmjet deklarimit të subjektit, trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore dhe ia përcolli kërkesën Komisionit, me qëllim shortimin e një trupi gjykues që do të merrte në shqyrtim kërkesën e subjektit për përjashtimin e relatores së çështjes, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 84/2016."

**20.2.4** Trupi gjykues i ngritur me shortin e miratuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 6.5.2021, të Komisionit, i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Valbona Sanxhaktari dhe Roland Ilia, me vendimin e datës 6.5.2021, ka vendosur mospranimin e kërkesës së subjektit për përjashtimin e trupit gjykues, si kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova, me arsyetimin se: *“Në vlerësim të pretendimeve të subjektit dhe shkaqeve të parashtruara prej tij në kërkesën e bërë në seancën dëgjimore të datës 6.5.2021, trupi gjykues nuk gjen të përmbushura asnjë nga pengesat ligjore të parashikuara nga neni 30 i Kodit të Procedurave Administrative. Neni 30 përmban kufizime që synojnë të sigurojnë objektivitetin dhe paanësisë e personave që do të kryejnë procedurat administrative të verifikimit dhe kontrollit, duke ndaluar përfshirjen në këto procedura të anëtarëve, të cilët janë ose mund të jenë në “marrëdhënie të caktuara” me palët në procedurë administrative. Nëse konstatohen ndonjë nga ato shkaqe, anëtari duhet të përjashtohet, duke mos e konsideruar të nevojshme që të provohet se personi do të veprojë në favor të një pale për shkak të arsyeve të paligjshme. Nga vlerësimi i përgjithshëm i kërkesës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se problematikat e ngritura nga ai kanë të bëjnë me përcaktime ligjore dhe norma kushtetuese, të cilat nuk mund të jenë objekt vlerësimi i këtij trupi gjykues, pasi legjitimiteti i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është vlerësuar nga organet kushtetuese të përcaktuara në Kushtetutë dhe emërimi i anëtarëve të tij është bërë me vendimin nr. 82/2017 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”.*

**20.2.5** Trupi gjykues, në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e

funksioneve publike”, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në rregulloren “Për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, miratuar me vendimin nr. 2, datë 19.7.2017, vendosi mos pranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, z. Avni Kraja, si kërkesë e pabazuar në ligj dhe në prova.

Ky vendim iu njoftua menjëherë subjektit me anë të postës elektronike, në datën 6.5.2021, si dhe iu dërgua nëpërmjet shërbimit postar.

**20.2.6** Në seancën e datës 6.5.2021, trupi gjykues, pasi njoftoi ndërprerjen e seancës me qëllim shqyrtimin e kërkesës për përjashtim të relatores nga një tjetër trup gjykues, lajmëroi se seanca do të rifillonte në datën 7.5.2021, në orën 09:30.

## **V. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**21.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**22.** Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>1</sup>, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**23.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shpresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shpresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; si dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e

---

<sup>1</sup> “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, apo nëpërmjet postës elektronike.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**24.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

**25.** Subjekti i rivlerësimit, z. Avni Kraja, ka punuar në periudhat:

- 1.8.1992 – 30.3.1995, prokuror në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës;
- 1.4.1995 – 28.10.1997, drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
- nëntor 1997 – 31.10.1998, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë;
- 27.12.2001 – 10 .6.2008, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë;
- tetor 2010 e në vijim, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **A/1. RIVLERËSIMI I PASURISË**

Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

**1. Apartament banimi me sip. 135.5 m<sup>2</sup>**, me adresë: rr. “\*\*\*\*”, blv. “\*\*\*\*”, p. “\*\*\*\*” , k. i \*\*\*-të, ap. \*\*\*, Tiranë. Apartamenti është blerë me kontratën e porosisë nr. \*\*\*, datë 7.9.2007, lidhur me grupin e investitorëve: “\*\*\*\*” sh.p.k.; “\*\*\*\*” sh.a.; si dhe shtetasen Y. S. .

#### **Burimi sipas deklaratës *Vetting*:**

i) Të ardhura nga shitja e katit të tretë të banesës me sip. 160 m<sup>2</sup>, ndërtuar në vitin 2001, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, me nr. \*\*\*, në shumën 6,900,000 lekë, shtetasit E. K. (vëllai i subjektit). Shitja e katit të tretë, e cila është në bashkëpronësi, vërtetohet me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, në datën 9.11.2007.

ii) Kredi në shumën 35,000 euro, sipas kontratës së kredisë bankare nr. \*\*\*, të lidhur në datën 22.4.2008, me BKT-në. Kredia është akorduar me afat 10 vjet dhe është marrë për blerjen e apartamentit te pala shitëse, e përfaqësuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., shoqëria “\*\*\*\*” sh.a. dhe shtetasja Y. S. . Gjendja e mbetur e kredisë në datën e deklaratës *Vetting* është 5,832.7 euro.

iii) Të ardhura të krijuara nga puna e subjektit ndër vite, që prej datës 1.8.1992, dhe e bashkëshortes, si dhe të ardhurat e përfituara nga vendimi nr. \*\*\*, datë 20.11.2001, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë “Për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit”, vërtetuar edhe nga vërtetimi nr\*\*\* prot., datë 25.1.2017, i lëshuar nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Prokuroria e Përgjithshme, në shumën 1,351,043 lekë.



**Vlera përfundimtare e blerjes: 105,000 euro.** Subjekti ka deklaruar se pagesa është bërë në numrin e llogarisë së grupit të investitorëve në euro, me nr. \*\*\*, në “Tirana Bank”, në shumën 105,000 euro.

## **1.1 Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni<sup>2</sup>**

**1.1.1** Pasuria objekt shqyrtimi rezulton të jetë deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2008 dhe konkretisht subjekti ka deklaruar: *“Pakësim i gjendjes cash (të akumuluar ndër vite) për të likuiduar pagesën e një pjese të detyrimit (30,000 euro) ndaj shoqërisë së ndërtimit për blerje apartamenti, të deklaruar në vitin 2007”*.

**1.1.2** Në seksionin e detyrimeve të DIPP-së së vitit 2008, subjekti ka deklaruar: *“Detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë së ndërtimit është 81,770 euro (për blerje apartamenti në rrugën ‘\*\*\*’, me sip. 135.3 m<sup>2</sup>, në nëntor të vitit 2007, në shumën 121,770 euro), likuiduar prej saj në vitin 2007, shuma 40,000 euro”*. Në DIPP-në e vitit 2008 subjekti ka deklaruar: *“Pakësimin e gjendjes cash 3,500,000 lekë për likuidimin e pagesës së detyrimit ndaj shoqërisë së ndërtimit për blerje apartamenti të deklaruar në vitin 2007. Detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë së ndërtimit (për blerje apartamenti në rrugën ‘\*\*\*’, me sip. 135 m<sup>2</sup>, në shumën 121,770 euro ) në vitin 2007 janë shlyer 40,000 euro dhe detyrimi ka qenë 81,770 euro. Me pagesën 65,000 euro detyrimi ndaj shoqërisë së ndërtimit është mbyllur, pasi një pjesë e punimeve të parashikuara në kontratën paraprake do t’i kryej vetë. Vlera përfundimtare e banesës është 105,000 euro, që do pasqyrohet në kontratën përfundimtare me dorëzimin e objektit. Pagesa 65,000 euro është me burim 30,000 euro nga pakësimi i gjendjes cash dhe 35,000 euro nga kredia e marrë në BKT.*

**1.1.3** Konstatohet se kontrata e porosisë nr. \*\*\* për këtë apartament është lidhur në datën 7.9.2007, por pavarësisht kësaj kjo pasuri nuk rezulton të jetë deklaruar nga subjekti në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2007.

**1.1.4** Në analizë të procesverbaleve të ardhura në Komision nga ILDKPKI-ja konstatohet se në procesverbalin e mbajtur në datën 15.3.2016, në ILDKPKI-së, subjekti mban të njëjtin qëndrim lidhur me shkakun e pagesës së vlerës 105,000 euro të vlerës së këtij apartamenti<sup>3</sup>.

---

<sup>2</sup>Subjekti ka bashkëlidhur si dokumentacion së bashku me deklaratën *Vetting*, duke përcjellë në funksion të deklarimit: vërtetim nga investitorët N. B., “\*\*\*” sh.a. dhe znj. Y. S., ku konfirmohet me shkresë të thjeshtë se sipas kontratës së porosisë blerësi Avni Kraja ka likuiduar shumën 105,000 euro, totalisht; faturë pagese në “Tirana Bank” për këstin e parë në shumën 40,000 euro, në datën 4.9.2007, këstin e dytë në shumën 15,000 euro, në datën 30.11.2007, dhe këstin e tretë në shumën 15,000 euro në datën 15.1.2008; deklaratë para noterit, me nr. \*\*\*, datë 9.11.2007, për shitjen e katit të tretë me sip. 160 m<sup>2</sup>, të një vile e cila ishte në bashkëpronësi, vlera e shitjes 6,900,000 lekë, e likuiduar plotësisht *cash* jashtë zyrës; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2017, nga Prokuroria e Përgjithshme, ku vërtetohet se z. Avni Kraja është paguar për vendimin gjyqësor të formës së prerë, me mandat nr. \*\*\*, datë 28.12.2001, në shumën 1,351,043 lekë; vërtetim nr.\*\*\* prot, datë 23.1.2017, nga BKT-ja, ku vërtetohet se z. Avni Kraja ka çelur në datën 29.4.2008 një linjë kredie në shumën 35,000 euro, gjendja e mbetur e kredisë në datën 23.1.2017 është 5,832.7 euro, shuma mujore e këstit të kredisë është 373.75 euro; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2017, nga BKT-ja, ku vërtetohet se në datën 22.4.2008, z. Avni Kraja ka nënshkruar me BKT-në kontratën e kredisë bankare nr\*\*\*, në shumën 35,000 euro, me qëllim “blerje apartamenti” tek pala shitëse “ \*\*\*” sh.p.k., “ \*\*\*” sh.p.k. dhe znj. Y. S. . Në datën 29.4.2008 klientit i çelet në llogarinë e tij personale kredia në shumën 35,000 euro dhe në datën 5.5.2008 fondet janë transferuar tek pala shitëse për blerje apartamenti.

<sup>3</sup> Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 8.1.2021.

**1.1.5** Në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2007, subjekti ka deklaruar shitje apartamenti me sip. 140 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, shtetasit E.K., në vlerën 6,900,000 lekë, me kontratën nr. \*\*\*, datë 9.11.2007.

**1.1.6** Komisioni konstaton se subjekti deklaroi kontratë, por akti është deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 9.11.2007, ku shtetasi E. K. (vëllai i subjektit) deklaroi se do të blejë shtëpi banimi në katin e tretë të një ndërtese private në rrugën “\*\*\*\*”, ndërtesë e cila ishte në proces legalizimi.

**1.1.7** Në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2007, subjekti nuk ka deklaruar detyrim ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetases Y. S., për blerje apartamenti me vlerë 121,770 euro. Nga faturat e pagesës bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, rezultoi se deri më 31.12.2007 subjekti ka paguar këstin e parë dhe të dytë në shumën 55,000 euro (datë 4.9.2007, shuma 40,000 euro dhe datë 30.11.2007, shuma 15,000 euro) dhe në vitin 2008 ka paguar në datën 15.1.2008 shumën 15,000 euro.

**1.1.8** Subjekti, i pyetur nga Komisioni lidhur me këtë, ka deklaruar se: *“Në lidhje me pretendimin e Komisionit se nuk është deklaruar prej meje detyrimi ende i pashlyer në DIPP-në e vitit 2007, dëshiroj të sqaroj se unë kam dhënë shpjegime në të njëjtin procesverbal mbi detyrimet që ende i kisha investitorëve. Citoj shpjegimin në procesverbal: ‘...subjekti deri në datën 31.12.2007 ka paguar shumën 40,000 euro dhe i ka mbetur detyrim firmës në shumën 81,770 euro. Me pagesën 65,000 euro detyrimi ndaj shoqërisë së ndërtimit është mbyllur, pasi një pjesë të punimeve të parashikuara në kontratën paraprake do t’i kryej vetë. Vlera përfundimtare e banesës është 105,000 euro, që do pasqyrohet në kontratën përfundimtare me dorëzimin e objektit. Pagesa 65,000 euro është me burim 30,000 euro nga pakësimi i gjendjes cash dhe 35,000 euro nga kredia e marrë në BKT”*.

Gjithashtu, në këtë vit (2008) subjekti deklaroi edhe kredinë e marrë për apartamentin “kredi në Bankën Kombëtare Tregtare”.

**1.1.9** Nga korrespondenca e Komisionit me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës<sup>4</sup>, Drejtoria Vendore Tiranë, nuk konfirmohet regjistrimi i kësaj pasurie në emër subjektit të rivlerësimit, pasi nuk rezultoi të jetë nënshkruar kontrata përfundimtare e shitjes, edhe pse detyrimi deklarohet i shlyer nga subjekti. Më ndryshimet ligjore<sup>5</sup> për pasuritë e paluajtshme subjekti rezervon të drejtën e regjistrimit të saj në ASHK. Nuk rezultoi e provuar nga dokumentacioni i marrë në shqyrtim se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë veprime administrative apo ligjore për të bërë të mundur kryerjen e regjistrimit.

**1.1.10** I pyetur nga Komisioni gjatë hetimit<sup>6</sup> për kohën kur ka filluar të banojë në apartamentin në rrugën “\*\*\*\*”, subjekti ka shpjeguar se *ka filluar të banojë në maj të vitit 2009, por nuk disponon procesverbal për marrjen në dorëzim të apartamentit, pasi ende sot nuk disponon certifikatë pronësie. Dokumentacioni ligjor i vetëm që disponon është kontrata e lidhjes së energjisë elektrike,*

<sup>4</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\*, datë 15.6.2020, në dosjen e Komisionit.

<sup>5</sup> Ligji nr. 118/2019, “Për kadastrën”, ligji nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>6</sup> Shihni përgjigjet nr. 1, pyetësor nr. 2.

*e lidhur në datën 6.1.2010. Në dijeninë e tij më të mirë, nga maji i vitit 2009 deri në datën e lidhjes së kontratës është furnizuar me energji elektrike në bazë të kontratës së lidhjes së energjisë elektrike që shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. ka pasur me operatorin KESH sh.a.*

**1.1.11** Kontrata e porosisë nr. \*\*\*, datë 7.9.2007, trajton: apartament me sip. 135.3 m<sup>2</sup> bruto, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, k. i \*\*\*-të, vlera: 121,770 euro. Pagesa do të kryhet: 40,000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës, 60,000 euro në janar të vitit 2008 dhe 21,770 euro në përfundim të objektit dhe marrjes së pronësisë përkatëse.

**1.1.12** Komisioni çmon se nuk rezultoi e provuar se vlera e paguar nga subjekti për këtë pasuri, në total në shumën 105,000 euro, më pak se vlera 121,770 euro e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, ka ardhur si pasojë e një marrëveshjeje ndërmjet grupit të investitorëve, shoqërisë së ndërtimit dhe subjektit.

**1.1.13** Subjekti, i pyetur nga Komisioni lidhur me marrëdhënien me shoqërinë investitore, grupin e investitorëve dhe shoqërinë ndërtuese, në pyetësonin nr. 1 ka sqaruar se *duke qenë se apartamenti ishte në katin e fundit të banimit dhe nga investitori ishte parashikuar që për ambientet e ballkoneve të bënte edhe investime të tjera shtesë të përfshira në kontratën e porosisë, ai nuk ka pranuar këtë investim, duke i lënë ballkonet si hapësira të lira dhe bosh. Gjithashtu, në kontratën e porosisë nr. \*\*\* ishte parashikuar në nenin 4 “Afatet dhe mënyra e pagesës”, në pikën 3, se pagesa prej 21,770 euro do të kryhej në përfundim të objektit dhe marrjes në dorëzim me procesverbal dhe aktin e pronësisë përkatës. Referuar nenit 5 të kontratës së porosisë është parashikuar një interes kamate prej 1 % për çdo muaj vonesë të llogaritur mbi tërë shumën e derdhur prej meje në rastin e mosrespektimit të nenit 4 nga pala investitore. Duke marrë përsipër detyrimin si rezultat i mosrespektimit të dorëzimit të aktit të pronësisë, por edhe mos marrëveshjet ndërmjet të tre investitorëve, të cilat janë të tilla që nuk do të ketë një zgjidhje përfundimtare me qëllim marrjen e titullit të pronësisë nga të gjithë banorët e pallatit, përfshirë edhe subjekti, ai ka negociuar për çmimin, duke dakordësuar çmimin 105,000 euro. Subjekti deklaroi gjithashtu në pyetësonin nr. 1 në apartamentin në rrugën “\*\*\*” ka filluar të banojë në maj të vitit 2009. Në dijeninë e tij më të mirë, për periudhën nga maji i vitit 2009 deri në datën e lidhjes së kontratës është furnizuar me energji elektrike në bazë të kontratës së lidhjes së energjisë elektrike që shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. ka pasur me operatorin KESH, shkaku nga hetimi rezultoi se librezja e energjisë elektrike me klientin Avni Kraja, e cila mban datën 6.1.2010. I pyetur në pyetësonin nr. 3, subjekti sërish deklaroi se nuk disponon akt dorëzimi, si dhe në dijeninë e tij shkaku i mosregjistrimit është konflikti ndërmjet grupit të investitorëve dhe shoqërisë ndërtuese ku dhe po bëhen përpjekje për të caktuar një përfaqësues për të vijuar këtë proces.*

**1.1.14** Komisioni iu drejtua shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. dhe grupit të investitorëve, referuar kontratës së porosisë nr. \*\*\*, datë 7.9.2007, me shkresën<sup>7</sup> për informacion lidhur me deklarin e subjektit për mospërmbushje të detyrimeve kontraktore nga shoqëria e ndërtimit, e cila ka sjellë si pasojë pagesën e shumës 105,000 euro për apartamentin e porositur, e ndryshme nga shuma 127,770 euro

e parashikuar ne kontratën e porosisë<sup>7</sup>. Shoqëria e ndërtimit “\*\*\*” sh.p.k., sqaron se ka qenë ne rolin e shoqërisë ndërtuese dhe gjithë marrëdhënia kontraktore ka qenë me grupin e investitorëve.

**1.1.15** Nisur nga deklarimi i subjekti se konfliktet dhe mospërmbushja në kohë e detyrimeve kontraktore ka çuar edhe në mosregjistrimin e saj në ZVRPP, Komisioni hetoi lidhur me faktin nëse në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kishte konflikte gjyqësore me palë shoqërinë ndërtuese “\*\*\*” sh.p.k. ose grupin e investitorëve. Nga përgjigjja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezultoi se asnjë nga proceset gjyqësore që palët, shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. dhe grupi i investitorëve ose palë të tjera ka, nuk janë me padi me objekt “mospërmbushje e detyrimit kontraktor”.

**1.1.16** Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për këtë pasuri, pasi:

- i) nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 kontratën e sipërmarrjes, të lidhur në datën 7.9.2007;
- ii) ka pasqyruar në mënyrë të pasaktë në DIPP-në e vitit 2008 vlerat dhe shlyerjet e detyrimit, duke deklaruar shlyerjen e një shume, e cila realisht është bërë në vitin 2007 (vlera 30,000 euro dhe vlera 40,000 euro);
- iii) ka paguar për këtë pasuri një vlerë më të vogël se ajo e kontratës së sipërmarrjes.

**1.1.17** Në parashtrimet e depozituara në Komision, në funksion të barrës së provës, subjekti ka pretenduar se:

➤ ***Lidhur me mosdeklarimet në DIPP-në e vitit 2007***

*“Komisioni, gjatë hetimit administrativ, i ka kërkuar ILDKPKI-së, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2021, informacion mbi procesverbalet e mbajtura nga ky institucion për mua si subjekt deklarues... Me përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021, janë vendosur në dispozicion të gjitha procesverbalet. Rezulton se me procesverbalin e mbajtur në datën 17.11.2008, në IILDKPKI, kam bërë sqarimet e nevojshme për pasaktësitë në DIPP-në e vitit 2007. Bashkëlidhur me procesverbalin është edhe kontrata e porosisë së lidhur midis palëve. Dua të vë në dukje se ka qenë pikërisht pasaktësia në deklaramin e DIPP-së së vitit 2007 arsyeja e mbajtjes së procesverbalit dhe deklaramit të të dhënave të sakta në këtë vit (pra, në vitin 2008)...”.*

➤ ***Lidhur me vlerën e apartamentin***

*“Sikurse kam shpjeguar edhe në përgjigjen e pyetësorit nr. 2, në pyetjen nr. 3, mbasi investitorët nuk realizuan punimet e parashikuara dhe për të cilat kishim rënë dakord, unë kam kryer punimet me punëtorët e shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k. dhe me materialet e blera me kosto po nga kjo shoqëri. Nuk disponoj faturë apo situacion për punimet e kryera, për shkak se vlera e shpenzuar nuk ka qenë e kërkuar të deklarohet në DIPP-të e atyre viteve (për herë të parë vlera e shpenzimeve mbi 300,000 lekë është bërë e detyrueshme me DIPP-në e vitit 2012).*

*... se arsyeja përse nuk është nënshkruar marrëveshja ndërmjet grupit të investitorëve dhe tij në cilësinë e blerësit për uljen e vlerës së blerjes së apartamentit është për faktin se një marrëveshje e*

---

<sup>7</sup> Zarfi i kthyer nga shërbimi postar bën me dije se shtetasja Y. S. nuk është më në adresën e deklaruar në kontratën e porosisë.

*tillë do nënshkruhet në momentin që do dalin certifikatat e pronësisë dhe në këtë marrëveshje do të pasqyrohet edhe vlera përfundimtare për blerjen e apartamentit...*

*... edhe në DIPP-në e vitit 2008 ka deklaruar faktin që vlera përfundimtare e apartamentit ishte 105,000 euro. Me deklaratën Vetting ka depozituar vërtetimin e nënshkruar nga grupi i investitorëve që blerësi Avni Kraja ka shlyer shumën prej 105,000 euro për blerjen e apartamentit dhe palët janë likuiduar në masën 100 %. Investitorët e kanë pranuar faktin që çmimi i blerjes është 105,000 euro (aq sa është paguar prej tij) dhe nuk kanë pasur dhe as kanë pretendime për çmimin sipas kontratës së porosisë... ”.*

Subjekti, pas dërgimit të barrës së provës, ka depozituar në Komision:

- Deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 8.4.2021, me të cilën investitorët “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, “\*\*\*\*”, me NIPT \*\*\* dhe shtetasja Y. S., me ID nr. \*\*\*) deklarojnë, nën përgjegjësinë e tyre personale dhe në vullnet të lirë dhe të plotë, se: *“Çmimi i apartamentit të porositur në kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 7.9.2007, ishte rënë dakord në vlerën 121,770 euro. Për shkak të ndryshimit të projektit fillestar, apartamenti i cili i është dorëzuar palës porositëse Avni Kraja ka pasur disa ndryshime sa i takon orientimit dhe moskryerjes së një sërë punimesh të marra përsipër nga investitorët, ndryshime të cilat e kanë ulur çmimin e shitjes së kësaj prone. Për këto arsye, nga ne palët është rënë dakord që porositësi të likuideojë shumën 105,000 euro dhe çmimi i shitjes do të konsiderohet i likuiduar”.*

- Deklaratën noteriale të lidhur midis investitorëve, ku deklarohet se çmimi i shitjes së apartamentit është 105,000 euro dhe është likuiduar totalisht nga blerësi Avni Kraja.

**Subjekti deklaroi se:** *“Për shkaqet e mësipërme, midis palëve u ra dakord në mënyrë verbale që çmimi nuk do ishte 121,770 euro, siç ishte përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, por do të ishte 105,000 euro. Pasi kam likuiduar vlerën 105,000 euro unë jam pajisur me vërtetimin përkatës nga investitorët që ky do ishte edhe çmimi përfundimtar i shitjes. Ndërkohë, unë vazhdoj të pres ende sot nënshkrimin e kontratës së shitjes, akt i cili do të më bëjë pronar të pasurisë për të cilën kam përdorur të gjitha kursimet e mia dhe që kam vazhduar të paguaj interesa për kredinë deri në datën 2 maj 2018”.*

**1.1.18** Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka depozituar në Komision një informacion, ku pasqyrohet se çmimi final i shitjes ka qenë 105,000 euro dhe është likuiduar nga subjekti Avni Kraja në llogarinë e investitores Y. S. në “Tirana Bank”.

**1.1.19** Trupi gjykues, pasi shqyrtoi parashtrimet e subjektit, si dhe e dëgjoi në seancë dëgjimore, lidhur me deklarinimin e pamjaftueshëm për këtë pasuri, vlerëson se:

- i) Subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 lidhjen e kontratës së porosisë dhe shlyerjen e kësteve për këtë pasuri.
- ii) Subjekti ka pasqyruar në mënyrë të pasaktë në DIPP-në e vitit 2008 vlerat dhe shlyerjet e detyrimit, duke deklaruar shlyerjen e një shume, e cila realisht është bërë në vitin 2007 (vlerat 30,000 euro dhe vlera 40,000 euro).

iii) Subjekti nuk ka paraqitur një procesverbal për marrje në dorëzim të apartamentit, ku të pasqyrohet qartë gjendja e tij në momentin e marrjes në dorëzim dhe punimet e papërfunduara që janë kryer më pas nga subjekti.

iv) Subjekti nuk disponon një preventiv të punimeve të kryera në këtë apartament.

v) Deklarata noteriale, e lidhur pas dërgimit të barrës së provës, nuk provon se çmimi i apartamentit është ai që subjekti ka paguar apo është deklaruar prej tij. Në kushtet kur një marrëdhënie juridike është formalizuar më anë të një kontrate porosie, modalitet e saj mund të ndryshohen vetëm me një kontratë dhe jo nëpërmjet një deklarate noteriale. Për këtë arsye, Komisioni, në vlerësim të deklarimit lidhur me këtë pasuri, vlerëson se çmimi i apartamentit është 121,770 euro dhe jo 105,000 euro, siç ka deklaruar subjekti.

## **1.2 Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie**

**1.2.1 Të ardhura nga shitja e katit të tretë të banesës me sip. 160 m<sup>2</sup>,** ndërtuar në vitin 2001, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, në shumën 6,900,000 lekë, shtetasit E. K. (vëllai i subjektit).

- Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën *Vetting*, si dokumentacion provues, deklaratën noteriale nr. \*\*\*, në datën 9.11.2007.

- Për herë të parë për këtë pasuri subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2004, duke deklaruar shtëpi banimi, me sip. 110 m<sup>2</sup>, kati i tretë, ndërtuar nga vetë subjekti në vitin 2001, në rrugën “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, e pahipotekuar. Pjesa takuese: 33 %, pa deklaruar burimin e krijimit, me vlerë 2,000,000 lekë.

**1.2.2** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se për ndërtimin e katit të tretë në ndërtesën e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, kanë shërbyer:

a) të ardhurat nga shitja e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*”, Lushnjë; dhe

b) të ardhurat nga kursime nga paga<sup>8</sup>.

Lidhur me këtë pasuri, burimin e krijimit të saj dhe vlerën, subjekti e ka deklaruar edhe gjatë procesit administrativ në ILDKPKI. Në procesverbalin e datës 15.3.2016, i mbajtur në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar se ndërtimi i katit të tretë është kryer me të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes ndër vite, të ardhurat e përfituara nga një vendim gjykate, në shumën rreth 1,500,000 lekë, si dhe nga shitja e banesës në Kukës. Gjithashtu, subjekti deklaroi në ILDKPKI në vitin 2006 se kostoja e ndërtimit në rrugën “\*\*\*\*” është gjithsej 8,000,000 lekë, pjesa e tij takuese 33 % dhe ku si burim kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Kukësit, në vlerën 3,000,000 lekë.

**1.2.3** Trupi gjykues konstaton se subjekti ka mbajtur një qëndrim jo koherent lidhur me burimin e kësaj pasurie dhe vlerën e saj në deklaratën *Vetting* dhe në ILDKPKI.

### ***Lidhur me apartamentin në lagjen “\*\*\*\*”, Lushnjë***

---

<sup>8</sup> Të ardhurat nga paga janë analizuar tek analiza financiare.

**1.2.4** Subjekti Avni Kraja ka përfiturar një apartament banimi në Lushnjë në vitin 1996, referuar autorizimit të datës 8.3.1996, të Bashkisë Lushnjë. Gjatë hetimit dhe analizës së dokumentacionit të depozituar për përfitim të këtij apartamenti dhe kuadrit ligjor të kohës<sup>9</sup>, Komisioni i drejtua Entit Kombëtar të Banesave<sup>10</sup> dhe Drejtorisë së Gjendjes Civile. Në analizë të dokumentacionit rezultoi e provuar se subjekti nuk ka qenë asnjëherë i regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile Lushnjë dhe dokumentacioni i paraqitur prej tij në përfitim të kësaj banese nuk përputhet me kërkesat ligjore të kohës dhe me përgjigjen e institucioneve. Ndër të tjera, theksohet se në momentin e përfitimit të banesës subjekti nuk ka qenë i regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile Lushnjë dhe nuk ka qenë asnjëherë i regjistruar në këtë qytet. Trupi gjykues shton në këtë vlerësim faktin se subjekti në këtë kohë ka ushtruar detyrën e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, detyrë të cilën duhet ta ushtronte duke banuar në këtë qytet.

**1.2.5** Subjekti, lidhur me këtë pasuri, shpjegon se: *“Në lidhje me konstatimin e Komisionit se përfitimi i apartamentit në Lushnjë nuk përputhet me kërkesat ligjore të kohës dhe nuk përputhet me përgjigjen e institucioneve, vlerësoj se ky konstatim nuk është i saktë dhe i drejtë. Komisioni, në rezultate paraprake të hetimit, nuk ka kryer arsyetim ligjor të arsyeve në të cilat bazohet për të arritur në një konkluzion të tillë gjë që objektivisht pamundëson dhënien e argumenteve të kundërt prej meje në funksion të mbrojtjes. Subjekti sqaron se apartamentin e ka përdorur duke filluar nga viti 1996. Nisur nga fakti se për shkak të trazirave të vitit 1997 dokumentacioni është dëmtuar dhe është bërë sërish nga fillimi në vitin 1999. Vlerësoj se përfitimi i apartamentit në Lushnjë, në kushtet kur unë kam qenë i transferuar me punë më këtë qytet, është në përputhje me parashikimet ligjore të VKM-së nr. 49, datë 19.1.1993, dhe të VKM-së nr. 291, datë 21.6.1994, pika 2, ku thuhet: ‘Për qytetarët që kanë përfiturar nga ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, ‘Për privatizimin e banesave shtetërore’, si ushtarak, të transferuar, persona shtetërore’”.*

**1.2.6** Trupi gjykues çmon se, pavarësisht se subjekti dhe familjarët e tij nuk kanë qenë asnjëherë të regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile Lushnjë, ai ka qenë një funksionar publik, i cili ka ushtruar funksionin në një qytet tjetër nga banimi i tij. Për këtë arsye, duke marrë në konsideratë faktin që dokumentacioni është riplotësuar nga subjekti, kjo për shkak të djegies në vitin 1997, Komisioni çmon se subjekti ka përfiturar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi banesën në qytetin e Lushnjës.

***Lidhur me pasurinë ndërtesë, me sip. 131.30 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, në rrugën \*\*\*\****

**1.2.7** Nga hetimi rezulton se shtetasi D. K., babai i subjektit, me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 17.03.1997, ka blerë nga shtetasit L., A., B. dhe Z. K. një godinë banimi të ndodhur në rrugën \*\*\*\*, \*\*\*, e përbërë nga 2 dhoma, aneks dhe korridor. Kjo pronë ka qenë e regjistruar në zbatim të vendimit gjyqësor nr. datë \*\*\*, datë 26.5.1980, me objekt “vërtetim fakti i pronësisë në zyrën e hipotekës Tiranë, me nr. \*\*\*, datë 25.11.1996”. Nga vendimi gjyqësor rezulton se pala shitëse nuk

<sup>9</sup> Ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”; VKM-ja nr. 49, datë 29.1.1993, “Për përcaktimin e kritereve për të pastrehët”; VKM-ja nr. 530, datë 17.10.1994, “Për mënyrën e ndarjes së apartamenteve të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave”.

<sup>10</sup> Shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2021, dhe certifikata e gjendjes civile në kohën kur subjekti ka kryer të gjitha veprimet me Entin Kombëtar të Banesave.

ka qenë pronare e tokë truall, me sip. 969 m<sup>2</sup>, e cila ka qenë objekt i kontratës së shitjes. Në këtë sipërfaqe trualli, subjekti, së bashku me babain dhe vëllezërit e tij, kanë ndërtuar pa leje në vitin 2001 një ndërtesë trekatëshe.

**1.2.8** Në dokumentacionin e dorëzuar, bashkëlidhur praktikës së legalizimit për pasurinë e llojit “truall”, me sip. 398.90 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\* dhe ndërtesë me sip. 130.30 m<sup>2</sup>, konstatohet se në *gen plan*-in e pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, pasuria mbi të cilën ka ndërtuar pa leje e ka statusin juridik shtet. Në kopjen e kartelës së pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\* dhe në planshetin e viteve 1980 - 1981 gjendet e pozicionuar godina të cilën shtetasi D.K. ka blerë sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 17.3.1997.

**1.2.9** Komisioni iu drejtua disa herë ASHK-së për informacion dhe dokumentacion tekniko-ligjor, si dhe material hartografik lidhur me gjendjen juridike të kësaj pasurie në vitin 1980, në vitin e blerjes nga shtetasi D. K. dhe aktualisht. Ky institucion nuk vuri asnjëherë në dispozicion të Komisionit informacion se çfarë ka ndodhur me këtë pasuri.

**1.2.10** Referuar dokumentacionit të ASHK-së<sup>11</sup> në hartat treguese të vjetra, rezulton banesa e vjetër, ndërsa në dokumentacionin për certifikimin dhe regjistrimin e ndërtimit pa leje nuk konstatohet më as gjurma e godinës së blerë nga shtetasi D. K. .

Për sa më sipër, Komisioni konstatoi paqartësi lidhur me faktin se çfarë ka ndodhur me godinën e blerë nga babai i subjektit Avni Kraja, shtetasi D. K., me përshkrimin “godinë banimi në rrugën ‘\*\*\*’, me nr. pasurie \*\*\*, z. k\*\*\*.

**1.2.11** Subjekti, lidhur me këtë pasuri, ka sqaruar se: *“Në lidhje me këtë paqartësi se çfarë ka ndodhur me godinën e blerë nga babai im D. K., me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, sqaroj Komisionin se kjo pasuri është djegur pjesërisht në janar të vitit 2003. Referuar procesverbalit të këqyrjes së vendit të ngjarjes të Komisarariatit të Policisë nr. 3, datë 16.1.2003, rezulton të këtë rënë zjarr në banesën e shtetasit A. F., me adresë: rrugën ‘\*\*\*’. Kjo banesë në përfundim kufizohet me banesën e shtetasit D. K. . Në aktin e ekspertimit të datës 16.1.2003, mbajtur nga ekspertët R. G., P. T. dhe Q.V. përshkruhet se rezultat i zjarrit të rënë pati dëmtime edhe tek tre fqinjët e tjerë që i kishin banesat nën një çati me zotin A. F.”.*

**1.2.12** Komisioni, në përfundim të analizës së provave, konstaton se nuk ka një dokumentacion referues dhe subjekti nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit procesverbalin nr. \*\*\*, datë 16.1.2003, si dhe procedurën e ndjekur nga institucionet shtetërore në rastin e fatkeqësive. Në zbatim të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001, ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile”, kreu i III-të, “strukturat e planizimit dhe të përballimit të emergjencave civile në nivel qarku, bashkie dhe komune”, strukturat vendore ndjekin një procedurë të posaçme në rastet e fatkeqësive të tjera<sup>12</sup> në kuptim të këtij ligji, gjë e cila nuk rezulton e realizuar në rastin konkret.

<sup>11</sup> Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 22.12.2020; shkresë nr. \*\*\*, datë 11.1.2021; shkresë nr. \*\*\*, datë 15.1.2020.

<sup>12</sup> “Fatkeqësi të tjera” kuptohen aksidentet rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, si dhe zjarret, shpërthimet, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore, ekologjike ose industriale dhe çdo lloj tjetër aksidenti të shkaktuar nga veprimi njerëzor, nga luftërat ose gjendjet e emergjencës, si dhe format e tjera të dhunës masive.



**1.2.13** Nga hetimi i Komisionit rezultoi se subjekti Avni Kraja dhe vëllezërit e tij E., A., B. dhe D.K. janë pajisur me leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 11.1.2016, ndërtesë me sip. 131.30 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*” dhe të sipërfaqes së truallit 398.90 m<sup>2</sup>, në të cilën subjekti rezulton pronar me 1/5 pjesë, si të objektit tre katësh, edhe të truallit në të cilën është ndërtuar ky objekt.

- Gjendja juridike e kësaj prone është e tillë dhe rezulton bashkëpronësia me njëjtat pjesë takuese prej 1/5-ve për të gjithë bashkëpronarët, e verifikuar deri në datën e zhvillimit të seancës dëgjimore, sipas sistemit multifunksional të pasurive të paluajtshme (IPS).

- Rezulton se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* 1/5 pjesë të ndërtesës 3-katëshe të legalizuar, por vetëm të pjesën takuese të sipërfaqes së truallit.

- Në dosjen e ILDKPKI-së, ALUIZNI, me anë të shkresës<sup>13</sup> informon se shtetasit E., A., Avni, B. dhe D. K. janë pajisur me lejen e legalizimit nr. \*\*\*, datë 11.1.2016, për një objekt me sip. 398.9 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi 131.3 m<sup>2</sup>, 3 kate mbi tokë, me sipërfaqe totale prej 438.7 m<sup>2</sup>.

**1.2.14** Nga hetimi rezultoi e provuar se për legalizimin e këtij objekti ka aplikuar me kërkesë për legalizim babai i subjektit, z. D. K., në datën 23.3.2005, ku objekti i ndërtuar deklarohet me 3 kate shtëpi banimi, me sipërfaqe të zënë 600 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimore 200 m<sup>2</sup>. Nga dosja e administruar Komisioni konstatoi gjithashtu se edhe subjekti ka bërë një kërkesë për legalizim në datën 10.11.2006, në përmbajtje të të cilës konstatohet se objekti për të cilin ka kërkuar legalizim, ka përshkrimin “sipërfaqja e zënë 200 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi 140 m<sup>2</sup>, numri i kateve mbi tokë 3”.

**1.2.15** Subjekti, i pyetur gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me këtë kërkesë, ka deklaruar se nuk bëhet fjalë për një ndërtim të ri, por është i njëjti ndërtim, si pjesë e ndërtimit me tre kate.

**1.2.16** Nga dokumentacioni rezulton se procedura e legalizimit është bërë për të gjithë objektin në tërësi dhe jo për kate të veçanta të tij, duke u legalizuar vetëm në emër të babait të subjektit të rivlerësimit, z. D. K. .

Pra, rezultoi e provuar se nuk kemi të bëjmë me një kërkesë për legalizim të një ndërtimi të ri nga subjekti, por për një deklaram për katin e tretë të ndërtesës, e cila më pas është legalizuar si një e tërë në emër të babait të subjektit, z. D. K. .

**1.2.17** Në janar të vitit 2021, subjekti i rivlerësimit, gjatë procesit të rivlerësimit, 5 vite më vonë nga legalizimi i këtij ndërtimi, lidh me vëllain e tij E. K. një kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme, me nr. \*\*\*, datë 20.1.2021, me 1/5 pjesë e ndërtesës në bashkëpronësi. Objekt i kësaj kontrate është shitja e pasurisë së paluajtshme ndërtesë, me të dhënat 1/5 pjesë takuese nga pasuria në bashkëpronësi, e ndodhur në Tiranë, regjistruar në ASHK, Drejtoria Tirana Veri, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f\*\*\*, me palë shitëse Avni Kraja dhe palë blerëse E. K. . Palët bien dakord që çmimi i plotë i shitjes së kësaj prone është:

a) Çmimi i shitblerjes së 1/5 pjese e ndërtesës me pëlqim të të dyja palëve është në vlerën 6,900,000 lekë.

<sup>13</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 3.10.2018, e ALUIZNI-t, Aneksi nr. 31, ILDKPKI.

b) Palët deklarojnë se kjo vlerë është likuiduar totalisht mes tyre, sipas aktit noterial, deklaratë noteriale nr\*\*\*, datë 9.11.2007, rikonfirmuar edhe me aktin noterial nr. \*\*\*, datë 19.11.2020.

c) Palët deklarojnë se nuk kanë asnjë pretendim në lidhje me çmimin dhe mënyrën e pagesës parashikuar sa më lart; pala blerëse nuk ka asnjë pretendim lidhur me vlerën e parapaguar për blerjen e kësaj pjese takuese, pavarësisht nëse ka ndryshime në sipërfaqe të shitur në vitin 2007 apo asaj që shitet sot, me 1/5 pjesë takuese, pasi objekti ka qenë në procedura legalizimi dhe titulli është përfituar me legalizim nga trashëgimlënësi tyre, babai D. K., dhe më pas ka kaluar në pjesë të barabarta takuese për të gjithë trashëgimtarët ligjorë të ish-pronarit D. K. .

**1.2.18** Subjekti, i pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, ka deklaruar se: *“Sqaroj se kam shpjeguar gjerësisht në pyetësor se për të vërtetuar faktin se unë realisht nuk zotëroj asnjë sipërfaqe në këtë objekt kam nënshkruar shitjen e pjesës time takuese në favor të vëllait tim E. K. . Nënvizoj se pjesa ime takuese prapë nuk është e barabartë me sipërfaqen e shitur në vitin 2007, por vëllezërit do të dakordësonin për shitjen përfundimtare. Sqaroj se unë faktikisht nuk e kam ndjerë dhe nuk e ndjeja veten pronar të pjesës takuese për objektin 3-katësh. Që prej momentit kur jam zhvendosur në apartamentin ku jetoj aktualisht, nuk kam pasur asnjë lidhje me objektin. Nuk e kam përdorur, poseduar dhe se kam pronësi reale mbi të. Pas deklaramit të shitjes në DIPP-në e vitit 2007 unë nuk e kam deklaruar në asnjë rast pronësinë mbi ndërtesën. Në deklaratën Vetting nuk kam deklaruar për çfarë jam pronar realisht vetëm si bashkëpronar i pjesës takuese të truallit me sipërfaqe 398.3 m<sup>2</sup>. Ka qenë pikërisht problematika e sqaruar në pikën “b” arsyeja që unë ende zotëroj pjesën takuese të ndërtesës 3-katëshe. Nuk ka qenë arsyeja apo qëllimi im të kryej deklaramit të rremë. Madje, nëse do deklaroja pjesën takuese në bashkëpronësi për ndërtesën, gjykoj se një fakt i tillë do të përbënte deklaramit të rremë, për shkak se unë e kisha shitur katin e tretë të ndërtesës dhe nuk kisha më pjesë takuese në këtë objekt. Ndonëse në certifikatën e pronësisë unë zotëroj 1/5 pjesë takuese, në fakt kjo nuk afektonte të drejtën reale të pronësisë që vëllai im E.K. kishte mbi katin e tretë. Sqaroj se certifikata e pronësisë është lëshuar në datën 14 tetor 2016 dhe se deri në momentin e dorëzimit të deklaratës Vetting nuk kisha kryer asnjë veprim mbi shitjen dhe sistemimin e situatës së pronësisë ndërmjet meje dhe vëllait tim E. . Çelja e dëshmisë së trashëgimisë dhe lëshimi i certifikatës së pronësisë mbi këtë pronë komplikuan veprimet e shitjes që unë duhet të kryeja me vëllain. Nëse nga ALUIZNI do të ishte marrë në konsideratë vetëdeklaramiti i dorëzuar prej meje në datën 10.11.2006, vetëm për katin e tretë të banimit, një gjë e tillë do të kishte bërë të mundur zgjidhjen si të faktit të pronësisë mbi katin e tretë, ashtu edhe të ligjshmërisë së të ardhurave për vlerën e shitjes 6,900,000 lekë, në kuptim të pagimit të detyrimeve përkatëse tatimore për të ardhurat nga shitja e pasurisë në momentin e regjistrimit të këtij veprimi juridik.*

*Për arsye se sipërfaqja e 1/5 pjesë takuese nuk ishte e barabartë me sipërfaqen e katit të tretë që unë i kisha shitur vëllait nuk kam arritur t'i jap zgjidhje nga momenti i lëshimit të certifikatës së pronësisë më 14.10.2016, deri në momentin e dorëzimit të deklaratës Vetting më 29.1.2017. Pas dorëzimit të deklaratës Vetting vlerësova që të gjitha veprimet që mund të kryeja do të ishin të paragjykuara dhe eventualisht mund të ngrinin dyshime të paarsyeshme në funksion të procesit të rivlerësimit. Në këto kushte, vendosa që në momentin e përgjigjeve të pyetësorit do të merrja*

*veprimet e duhura ligjore, si për sqarimin e pronësisë, ashtu edhe për transferimin e saj nga unë tek vëllai”.*

**1.2.19** Në analizë të provave dhe fakteve të analizuara më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm kryerjen e veprimeve juridike për shitjen e katit të tretë të banesës në rrugën “\*\*\*\*”. Deklarata noteriale e lidhur në vitin 2007 nuk mund të konsiderohet si një veprim juridik i kalimit të pronësisë. Në kushtet e mosregjistrimit të kësaj prone subjekti ka gjetur këtë mënyrë të kalimit të pronësisë për të legjitimuar të ardhurat e marra nga shitja, e cila duhej detyrimisht të finalizohet me një kontratë shitjeje. Kontrata e shitjes e lidhur gjatë procesit të rivlerësimit nuk përputhet në objekt me deklaratën noteriale dhe kati i tretë nuk është 1/5 e banesës trekatëshe. Vlera e shitjes, pavarësisht se sipërfaqja është më e vogël, është po në të njëjtën vlerë. Komisioni vëren gjithashtu se subjekti, si një nga bashkëpronarët, nuk mund ta shiste pjesën e tij pa miratimin e bashkëpronarëve të tjerë, kërkesë ligjore kjo në bazë të nenit 199 e vijues të Kodit Civil, pavarësisht marrëdhënieve familjare midis bashkëpronarëve.

### **1.3 Analiza financiare**

**1.3.1** Në analizë të burimit të ligjshëm, Komisioni kreu analizën financiare lidhur me momentet e shlyerjes së kësteve të apartamentit nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

**Kësti i I-rë** – shlyer në datën 4.9.2007, në vlerën 40,000 euro ose konvertuar në 4,836,400 lekë. PAGESA është bërë nëpërmjet “Tirana Bank”<sup>14</sup> në llogarinë e investitores Y. S. . Subjekti deklaroi<sup>15</sup> se për likuidimin e këstit të parë ka shërbyer shuma 6,900,000 lekë e përfituar nga shitja e katit të tretë të banesës në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë. Me anë të deklaratës *Vetting* është përcjellë deklarata noteriale nr. \*\*\*, e datës 9.11.2007, në të cilën subjekti, në cilësinë e shitësit, deklaroi se shuma 6,900,000 lekë është likuiduar jashtë zyrës noteriale nga blerësi i pronës, z. E. K. (vëllai i subjektit).

**1.3.2** Pas shqyrtimit të dokumentacionit është konstatuar mospërputhje e datave, e kryerjes së pagesës të këstit të parë (datë 4.9.2007) me datën e nënshkrimit të deklaratës noteriale (datë 9.11.2007).

**1.3.3** Subjekti<sup>16</sup>, i pyetur nga Komisioni, shpjegon në lidhje me mospërputhjen se *deklarata noteriale ka shprehur faktin se likuidimi i shumës 6,900,000 lekë është bërë plotësisht cash jashtë, pra, jo me bankë. Ky përshkrim tregon faktin se vëllai i kishte shlyer shumën 6,900,000 lekë dhe jo se me përpilimin e deklaratës noteriale ishte bërë edhe shlyerja e shumës. Nisur edhe nga ky keqkuptim i krijuar, ka nënshkruar me vëllain E. K. deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 19.11.2020, duke shprehur vullnetin se është likuiduar shuma 6,900,000 lekë përpara datës 4 shtator 2007 dhe se subjekti nga ana tjetër do të transferonte të gjitha të drejtat në lidhje me katin e tretë të shtëpisë private.*

Subjekti sqaron se shuma 6,900,000 lekë, e likuiduar nga vëllai E. K. tek ai, është bërë me pagesa *cash*, duke tërhequr vlerat e tyre nga llogaria rrjedhëse në “ProCredit Bank”, si vijon:

<sup>14</sup>Shihni Aneksin nr. 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>15</sup>Shihni përgjigjen nr. 4 b., në pyetësorin nr. 2.

<sup>16</sup>Shihni përgjigjen nr. 4 b. në pyetësorin nr. 2.

- datë 11.4.2007 – shuma e tërhequr 20,000 euro;
- datë 12.4.2007 – shuma e tërhequr 10,000 euro;
- datë 30.4.2007 – shuma e tërhequr 20,000 euro;
- datë 2.5.2007 – shuma e tërhequr 10,745 euro.

**1.3.4** Nga korrespondenca e Komisionit me “ProCredit Bank”<sup>17</sup> konfirmohen veprimet e mësipërme. Tërheqja e shumave të lartpërmendura nga kjo bankë rezulton të jetë kryer 5-6 muaj para datës së pagesës së këstit të parë nga subjekti.

**1.3.5** Mbështetur në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit se dhënia e vlerës nga z. E. K. tek subjekti i është bërë *cash*, trupi gjykues çmon se nuk arrihet të provohet në mënyrë shteruese se vlera e shlyer nga z. Avni Kraja është marrë nga vëllai i tij.

**1.3.6** Subjekti deklaron se ka nënshkruar kontratën e shitjes në janar të vitit 2021, për të vërtetuar faktin se ai realisht nuk zotëron asnjë sipërfaqe në këtë objekt, por jo sepse duhet të përfundonte veprimet juridike të nisura në vitin 2007 (me deklaratën noteriale me vëllain E. K.).

**1.3.7** Komisioni, në analizë të këtij burimi, pavarësisht se nuk rezultoi e provuar se kur ishte momenti i dhënies së vlerës prej 6.9000.000 lekësh nga vëllai, hetoi lidhur me faktin nëse këto të ardhura përmbushin kërkesat e pikës 3, të nenit D, të ligjit nr. 84/2016. Komisioni, gjatë hetimit, konstatoi se subjekti nuk kishte paguar detyrimet tatimore për vlerën e deklaruar të shitjes së banesës. Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore mbi vlerën e mësipërme të shitjes së pasurisë, nga DPT-ja<sup>18</sup> rezultoi se nuk ishin shlyer deri në datën 2.6.2020.

**1.3.8** Subjekti, pasi u pyet nga Komisioni, shpjegoi se<sup>19</sup> *në lidhje me pagesën e detyrimit tatimor për të ardhurat e realizuara nga shitja e katit të tretë të banesës trekatëshe në vitin 2007, në ligjin e kohës nuk parashikohet detyrimi për të paguar tatim për të ardhurat e realizuara nga shitja e një të drejte reale mbi një pasuri të paluajtshme të peregjistruar (jo në pronësi), pasi legjislacioni për tatimin mbi të ardhurat, në kohën e realizimit të kësaj të ardhure, nuk parashikonte si të ardhur të tatueshme fitimet kapitale të përfituara nga kalimi/transferimi i të drejtave reale mbi një pasuri të paluajtshme të peregjistruar. Tatueshmëria e kësaj të ardhure (të ardhurat e realizuara nga shitja e një të drejte reale të përfitur me kontratë) është parashikuar për herë të parë vetëm me ndryshimet që iu bënë ligjit nr. 8438 me ligjin nr. 94/2018, datë 3.12.2018, “Për një ndryshim në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”.*

**1.3.9** Subjekti ka deklaruar gjatë hetimit<sup>20</sup> se duke iu referuar qëndrimeve të sipërcituara dhe faktit se legjislacioni tatimor njeh pagesën me vonesë të detyrimit tatimor, ka bërë deklarin e fitimit kapital të realizuar në shumën 4,900,000 lekë dhe detyrimit 10 % që lind nga deklarimi, duke kryer gjithashtu edhe pagesën në shumën 490,000 lekë për detyrimin tatimor. Me deklarinin përcillet: urdhërpagesa në datën 20.1.2021, për kryerjen e pagesës së tatimit mbi të ardhurat individuale, me vlerë 490,000 lekë; kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 20.1.2021;

<sup>17</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.6.2020, të “ProCredit Bank”.

<sup>18</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 2.6.2020.

<sup>19</sup>Shihni pyetësin nr. 3, datë 22.1.2021, pyetja 1/a).

<sup>20</sup>Shihni pyetësin nr. 3, datë 22.1.2021, pyetja 1/a).

urdhërpagesa e “Credins Bank” për pagesën e tatimit mbi të ardhurat individuale të datës 20.1.2021; deklarata individuale vjetore e të ardhurave (DIVA) për vitin 2020, në të cilën vetëdeklarohet pagesa e vlerës 490,000 lekë si detyrim tatimor për t’u paguar.

**1.3.10** Komisioni, duke iu referuar legjislacionit të kohës, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, çmon se detyrimi tatimor mbi të ardhurën nga shitja e katit të tretë ka lindur nga momenti i nënshkrimit të deklaratës noteriale (datës 9.11.2007), përkatësisht i referohet nenit 8, “E ardhura e tatueshme” pika 1, “g”, ku përshkruhet se: *“Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme, të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”*. Ky nen plotësohet me nenin 8/1, *“Të ardhura të përjashtuara”*, nga ku nuk rezulton të jetë e ardhur e përjashtuar vlera e të ardhurës së marrë nga subjekti i rivlerësimit.

**1.3.11** Komisioni vëren se subjekti ka paguar tatim mbi të ardhurat individuale në janar të vitit 2021, në vlerën 4,900,000 lekë, kur kontrata e shitjes<sup>21</sup> së pasurisë përcakton çmimin e shitjes prej 6,900,000 lekësh. Diferenca e vlerave rezulton nga zbritja e kostos së ndërtimit të katit të tretë të deklaruar në DIPP-në e vitit 2004 në vlerën 2,000,000 lekë nga subjekti, ndërsa vlera e kostos së ndërtimit, e cila është marrë nga subjekti për llogaritjen e tatimit, është marrë mbi bazën e vetëdeklarimit në DIPP-në e vitit 2004 dhe mbi asnjë bazë tjetër.

### **1.3.12 Subjektit iu kalua barra e provës duke konstatuar se:**

- Subjekti përcjell pagesën e detyrimit tatimor për vlerën e shitjes së pasurisë së kryer në datën 20.1.2021, kohë gjatë së cilës është në proces rivlerësimi nga Komisioni dhe jo më herët, ku sipas shpjegimeve të tij nga viti 2018 me ndryshimet ligjore i kishte lindur me ligj pagesa e detyrimeve tatimore mbi shitjet e të drejtave reale.

- Rezulton<sup>22</sup> se subjekti ka realizuar kontratën e shitjes së pasurisë në janar të vitit 2021, ndërkohë kur pasuria e mësipërme është regjistruar në datën 25.11.2016, në ASHK-në Tiranë dhe prej kësaj datë mund të kishte proceduar me lidhjen e saj.

**1.3.13** Në lidhje me sa më sipër, subjekti pas kalimit të barrës së provës shpjegon: *“Vlerësoj se është më se logjik fakti që ishte pikërisht dakordësia me të ajo që më shtyu të blej apartamentin e ri. Unë ende vazhdoja të jetoja në katin e tretë edhe mbasi E. më kishte dhënë vlerën prej 6,900,000 lekësh. Duke qenë në një marrëdhënie familjare dhe vëllazërore nuk nënshkruam deklaratën në momentin që ai më vendosi në dispozicion shumë por e realizuam më vonë mbasi ai po kërkonte të interesohej për bërjen e dokumenteve të pronësisë.*

*Në lidhje me faktin se mund të kisha paguar detyrimin tatimor në vitin 2018 pas ndryshimeve ligjore për tatimin e të drejtës reale mbi pronësinë, sqaroj se ndryshimi ligjor në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat personale’, në vlerësimin tim nuk mund të kishte fuqi prapavepruese. Pasi jam njohur me qëndrimin e Komisionit në vendimin nr. 296, datë 16.9.2020,*

<sup>21</sup>Shihni kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, datë 20.1.2021.

<sup>22</sup>Shihni certifikatën e pronësisë të përcjellë me pyetëSORIN nr. 2 dhe bashkëlidhur deklaratës *Vetting*.

*(për subjektin A. M.), kam menduar se duhet të përmbush pagesën e detyrimit tatimor. Një gjë të tillë e bëra duke qenë i bindur se asnjëherë nuk ka qenë qëllimi i veprimeve apo mosveprimeve të mia mospagesa e ndonjë detyrimi tatimor në fuqi dhe për të bindur edhe më tej Komisionin në lidhje me këtë qëndrim timin;*

*Pasi jam njohur me relacionin paraprak dhe faktin që Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga shitja e katit të tretë në shumën 6,900,000 lekë duke i konsideruar si të ardhura jo të ligjshme i jam drejtuar me kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT). DPT, në përgjigjen e dhënë me shkresën nr. \*\*\* prot, datë 7.4.2021, në lidhje me transkasionet e kryera ndërmjet meje dhe vëllait tim E. K. ka sqaruar se:*

*Bazuar në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 9.11.2007, në momentin e përfitimit të shumës 6,900,000 lekë, individi përfitues nuk ka pasur detyrimin të paguajë tatimin mbi të ardhurat personale në zbatim të nenit 8 'E ardhura e tatueshme', të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, 'Për tatimin mbi të ardhurat', i ndryshuar. Me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme 1/5 pjesë e ndërtesës në bashkëpronësi nr. \*\*\*, datë 20.1.2021, është kryer kalimi i të drejtës së pjesës takuese të pasurisë së paluajtshme.*

*Në përfundim të shkresës konkludohet se pagesa e tatimit në shkallën tatimore 15% është kryer në momentin e regjistrimit të kësaj pasurie të kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme në datën 20.1.2021.*

*Nga përgjigja e dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, unë në momentin e arkëtimit të shumës 6,900,000 lekë, sipas deklaratës noteriale të datës 9.11.2007, nuk duhet të paguaja tatim. Kjo shumë është parapagimi për shitjen që unë do të kryeja në momentin e hipotekimit të pasurisë. Pagesa e tatimit për vlerën e shitjes së katit të tretë, referuar dispozitave ligjore por edhe shkresës së DPT-së është kryer në momentin e kalimit të pronësisë sipas kontratës së shijes nr. \*\*\*, datë 20.1.2021.*

*Vlerësoj se Komisioni duhet të njohë si të ardhura të ligjshme vlerën e shitjes së katit të tretë të shtëpisë private në shumën prej 6,900,000 lekësh. Kjo vlerë përmbush dy kushtet kumulative në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Kushtetutës, pasi buron nga një marrëdhënie e ligjshme (veprim juridik i lejuar nga ligji) dhe për të janë paguar detyrimet tatimore”.*

**1.3.14** Subjekti përcjell si provë shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.4.2021, nga DTP-ja, sektori i taksave direkte, drejtoria teknike dhe ligjore me të cilën, duke iu referuar momentit të nënshkrimit të deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 9.11.2007, konfirmohet se subjekti nuk ka pasur detyrim të paguajë tatim mbi të ardhurat personale në zbatim të nenit 8 “E ardhura e tatueshme”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

**1.3.15** Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit u pyet nga anëtarët e Komisionit, lidhur me çmimin e deklaruar të shitjes së banesës dhe detyrimit tatimor që subjekti ka paguar, vlerën dhe ecurinë e shlyerjes së detyrimeve pas lidhjes së kontratës së shitjes, i cili në sqarimet e tij shpjegoi se: “Dua t’ju shpjegoj se deklarata noteriale është bërë pasi unë kam marrë lekët. Këtë e kemi shprehur edhe me një deklaratë tjetër noteriale e cila duhet të jetë administruar nga ana juaj. Sa i

*takon detyrimeve, që në pyetësorët e parë e në vijim, kam mbajtur qëndrim se nuk më takon që të paguaj tatimin mbi këtë vlerë. Nuk e parashikonte ligji dhe i kam qëndruar asaj pjese. Në momentin që nga Komisioni është vendosur, pikërisht, për këtë shkak, pra, mospagimin e detyrimeve sipas ligjit të kohës të subjektit të rivlerësimit, e kam cituar këtu A. M., atëherë unë vendosa që ta paguaj pavarësisht se kisha dhe vazhdoj ta kem mendimin se nuk jam i detyruar ligjërisht që ta paguaj atë. Edhe pas pagesës së këtij detyrimi, pra të kërkuar nga ana juaj ose saktësisht të shprehur në vendimmarrje nga Komisioni kam bërë pagesën por megjithatë i jam drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve si organ që mbulon pikërisht këtë fushë dhe kam marrë përgjigje se nuk ju takon që të paguani tatimin për të cilin ju thoni. Po kështu, kam bërë kontratë shitje me vëllain, e kam sqaruar edhe në pyetësorët e mëparshëm, unë nuk e kam deklaruar pjesën e një e pesta takuese për shkak se një e pesta takuese nuk është e barabartë me një të tretën që unë kisha dhe kjo përmban dhe problematikë më vete. Sipas aktit të trashëgimisë pas vdekjes së babait, unë jam bërë pronar i 1/5 të ndërtesës ndërkohë që me deklaratë noteriale, se në atë kohë s'kam pasur, nuk ka qenë e formalizuar, nuk ka qenë e regjistruar si pronë, pra banesa ku unë jetoja bashkë me vëllezërit dhe në këto rrethana është.., kjo ka qenë pra arsyeja që nuk është bërë”.*

**1.3.16** Në analizë të kuadrit ligjor në fuqi, provave dhe fakteve, Komisioni çmon se subjekti kishte detyrimin të paguante tatimin mbi të ardhurën e deklaruar të përfituar nga shitja e katit të tretë, nga momenti i nënshkrimit të deklaratës noteriale në datën 9.11.2007.

- Në nenin 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, “E ardhura e tatueshme”, në pikën 1, germa “g”, parashikohet se: “Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme:

*g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”.*

- E ardhura e marrë/përfituar nga subjekti i rivlerësimit në mbështetje të pikës 1, të nenit 8, “Të ardhura të përjashtuara”, të po këtij ligji, nuk është në të ardhurat e përjashtuara të parashikuara në këtë nen.

**1.3.17** Gjithashtu, Komisioni vlerëson se edhe sikur të merreshin në konsideratë pretendimet e subjektit se detyrimi për të paguar tatimet ka lindur në vitin 2018, në bazë të neni 1, pika 1, germa “i”, e ligjit nr. 94/2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për Tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, i cili parashikon në nenin 4, “Burimi i të ardhurave”, bëhen ndryshimet e mëposhtme dhe germa “dh” ndryshohet në: “Pasuria e paluajtshme, aksesoret dhe frytet e tyre, si dhe të ardhurat që rrjedhin nga të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme që ndodhen në Republikën e Shqipërisë”.

Në datën 18.9.2018, ndryshohet ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar”, i cili e klasifikon veprimin juridik të kryer nga subjekti në grupin e nenit 11<sup>23</sup> të këtij ligji, sipërtrajtuar.

---

<sup>23</sup>“Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme”.

**1.3.18** Komisioni vlerëson se rrëzohet, gjithashtu, pretendimi që subjekti ngre se kjo pagesë është parapagimi për shitjen që do të kryente në momentin e hipotekimit të pasurisë, pasi nuk rezultoi e provuar që prej tij të jenë ndërmarrë veprime juridike, pavarësisht se hipotekimi i kësaj prone është bërë në vitin 2016.

**1.3.19** Komisioni çmon se nuk është i bazuar, gjithashtu, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave, duke paguar tatimin gjatë procesit të rivlerësimit, për faktin se:

Bazuar në nenin 11 “Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar”, në të cilin parashikohet se: “Fitimi kapital i realizuar si rezultat i kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, ndërtesë, truall dhe tokë bujqësore, tatóhet me normën 15%”. Shkëmbimi i truallit me sipërfaqe ndërtimi, në bazë të një kontrate shkëmbimi, nuk përbën moment për llogaritje të ndonjë fitimi kapital nga transferimi i pasurisë së paluajtshme”.

Tatimi paguhet nga individ që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Vlera e tatimit të paguar është 10% dhe jo 15%, sipas parashikimit të aktit të sipërcituar.

**Kësti i II-të** – shlyer në datën 30.11.2007, në vlerën 15,000 euro ose 1,813,650 lekë. Subjekti nuk e deklaroi në deklaratën *Vetting* apo në DIPP-në e vitit 2007, por gjatë hetimit<sup>24</sup> të Komisionit deklaroi pagesën e vlerës 15,000 euro nga bashkëshortja.

**1.3.20** Subjekti, ndër të tjera, shpjegon se: “...përveç pagesës së këstit të parë në shumën 40,000 euro kryer nga ana e tij në ‘Tirana Bank’, në datën 30.11.2007, nga ana e bashkëshortes A. K. është bërë pagesa në shumën 15,000 euro, subjekti sqaron<sup>25</sup> se nuk ka qenë në dijeni të pagesës në shumën 15,000 euro për shkak të krisjes së marrëdhënies me bashkëshorten ...”.

Kjo mos dijeni e tij ka ardhur edhe në vitin 2008, ku mendonte se bashkëshortja e kishte kryer pagesën në janar të vitit 2008, ashtu siç ishte parashikuar në nenin 4 të kontratës së porosisë dhe jo në nëntor të vitit 2007. Gjithashtu, subjekti deklaroi se: “Problemet sollën pasaktësitë në deklaratat e vitit 2007 dhe 2008. Për këtë arsye në deklaratën e vitit 2007 ndryshon edhe gjendja cash në fund të vitit duke u pakësuar me pagesën e kryer në vlerën 15,000 euro”.

**1.3.21** Ndërsa në pyetësin nr. 3, datë 22.1.2021, subjekti deklaroi se: “Në DIPP-në e vitit 2007, kam deklaruar shtim i gjendjes cash në shumën 700,000 lekë. Për shkak të pasaktësisë në deklaram të deklaratës, është mbajtur pranë ILDKPKI-së procesverbali i datës 17.11.2008, ku është sqaruar se përveç pagesës prej 40,000 euro kryer në datën 4.9.2007 është likuiduar edhe pagesa në shumën 15,000 euro në datën 30.11.2007. Për arsyet e shpjeguara në pyetësin nr. 1 unë nuk kam pasur dijeni mbi këtë pagesë. Kjo provohet edhe nga procesverbali i datës 17.11.2008. Pagesa në shumën prej 15,000 euro ka si burim krijimi diferencën e mbetur në shumën 1,900,000 lekë nga shitja e shtëpisë. Në DIPP-në e vitit 2008, kam deklaruar pakësim të gjendjes cash në shumën 3,500,000

<sup>24</sup>Shihni përgjigjen nr. 14 të pyetësorit standard.

<sup>25</sup>Shihni pyetjen nr. 14, në pyetësin standard.



*lekë. Në fakt, pakësimi i gjendjes cash është në shumën 1,600,000 lekë, pasi shuma prej 1,900,000 lekësh është likuiduar në vitin 2007”.*

**1.3.22** Komisioni konstatoi se kishte mospërputhje në deklaratimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit me deklaratimet në DIPP-në për vitet 2007-2008, për vlerat e paguara të kësteve të apartamentit dhe gjendjes së kursimeve. Subjekti nuk mban të njëjtin qëndrim në deklaratimet e tij, duke i ndryshuar disa herë gjatë hetimit të Komisionit. Gjatë heqimit subjekti herë deklaroi vlerat e kursimeve sipas DIPP-së dhe herë i ndryshoi me shpjegime të reja të përcjella me pyetësorët e Komisionit.

**1.3.23** Gjatë hetimit subjekti ka përcjell me deklaratën *Vetting* kopje të mandatpagesës të vlerës 15,000 euro, datë 30.11.2007, në “Tirana Bank”, derdhur në llogarinë e znj. Y. S. .

**1.3.24** Nga komunikimi shkresor me “Tirana Bank”<sup>26</sup> rezultoi se në këtë datë është kryer derdhje në llogarinë e znj. Y. S., në vlerën 15,000 euro, me përshkrimin “pagesë kësti i dytë”, e cila është bërë derdhje në arkën e bankës nga vetë titullari i llogarisë bankare znj. Y. S. .

**1.3.25** Subjektit iu kalua barra e provës për sa vijon:

- duket se kësti i dytë është shlyer me pagesë *cash* dhe më pas është derdhur në bankë nga investitori Y. S.;
- nuk provohet me dokumentacion se vlera e derdhur prej 15,000 euro është kryer si pagesë nga subjekti i rivlerësimit apo bashkëshortja sepse derdhja në llogarinë bankare është realizuar nga shtetasja Y. S. .

**1.3.26** Pas dërgimit të barrës së provës, subjekti parashtron: *“Në lidhje me këstin e dytë ... pagesa në shumën 15,000 euro, e kryer në datën 30.11.2007, në orën 11<sup>54</sup>, është urdhëruar dhe depozituar nga bashkëshortja ime A. K. . Në dokumentin “depozitë në arkë” duket fare qartë se firma e klientit përmban emrin dhe mbiemrin e bashkëshortes si dhe firmën e saj. Në përshkrimin e pagesës duhej të ishte përshkrimi A. K. dhe jo Y. S. . Megjithatë tregohet fare qartë se klienti udhëruar i transaksionit ka qenë bashkëshortja ime”.*

**1.3.27** Komisioni çmon se në analizë të provave dhe fakteve të përcjella nga subjekti pas dërgimit të barrës së provës rezultoi e provuar se pagesa e këstit prej 15,000 euro është bërë nga bashkëshortja e subjektit në llogarinë bankare të njërit prej investitorëve znj. Y. S. .

**1.3.28** Në lidhje me burimin e ligjshëm të deklaruar për këstin e dytë, Komisioni ka marrë në konsideratë deklarinë se si burim ka shërbyer diferenca e mbetur nga vlera shitjes së katit të tretë, në shumën 1,900,000 lekë, të cilën subjekti e ka deklaruar në procesverbalet e mbajtura nga ILDKPKI-ja, përkatësisht i datës 17.11.2008. Në referencë të analizës së vlerës totale të shitjes së pasurisë të trajtuar në këstin e parë rezultoi se edhe kësti i dytë është shlyer me burim të paligjshëm të ardhurash.

---

<sup>26</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2021, të “Tirana Bank”.

**1.3.29** Trupi gjykues çmon se në vlerësim të gjitha shkaqeve të parashtruara më lart, nuk ka përfshirë në analizën financiare dhe e ka konsideruar burimin e krijimit të pagesës së këstit të parë dhe të dytë të pasurisë apartament, me të ardhura jo të ligjshme, në përputhje me pikën 3, të nenit D, Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

**Kësti i III-të** – shlyer në datën 15.1.2008, në vlerën 15,000 euro ose 1,847,738 lekë.

**1.3.30** Subjekti deklaron në DIPP-në e vitit 2008: “*Pakësim i gjendjes cash (të akumuluar ndër vite) për të likuiduar pagesën e një pjesë të detyrimit (30,000 euro) ndaj shoqërisë së ndërtimit për blerje apartamenti. Gjendja cash e mbetur në 31.12.2008 është 1,000,000 lekë*”. Gjatë hetimit subjekti jep sqarimet e trajtuara më sipër me këstin e dytë, duke korrigjuar vlerën e këstit të paguar në vitin 2008 nga 30,000 euro në 15,000 euro.

**1.3.31** Subjekti ka përcjell me deklaratën *Vetting* mandatpagesën në “Tirana Bank”, ku duket se kjo vlerë është depozituar nga z. A. K. . Shkresa e “Tirana Bank”<sup>27</sup> e përcjellë në Komision konfirmon veprimin e deklaruar nga subjekti dhe depozituar nga z. A. K. .

**1.3.32** Në lidhje me burimin e ligjshëm të këstit të tretë të apartamentit mbështetur në deklaratimet në DIPP rezulton se burimi i krijimit është gjendja e kursimeve deri në vitin 2007, të cilat rezultojnë të jenë në vlerën 2,400,000 lekë.

**1.3.33** Komisioni çmon se në lidhje me burimin e ligjshëm të këstit të tretë të apartamentit mbështetur në deklaratimet në DIPP-në e vitit 2008, rezulton se burimi i krijimit është gjendja e kursimeve deri në vitin 2007, të cilat rezultojnë të jenë në shumën 2,400,000 lekë. Ndërsa gjendja e kursimeve e deklaruar në DIPP-në e vitit 2008 është në shumën 1,000,000 lekë, nga ku rezulton se pakësimi i gjendjes *cash*, e cila mund të jetë përdorur për pagesën e këstit të tretë është në shumën 1,400,000 lekë.

**1.3.34** Në rezultat të kësaj analizë subjekti iu kalua barra e provës:

- Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pagesën e plotë prej 15,000 euro ose 1,813,650 lekë, për shlyerjen e këstit të tretë të apartamentit, pasi ka rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në vlerën 552,263 lekë.

**1.3.35** Trupi gjykues, në analizë të provave dhe fakteve të administruara, çmon se subjekti ka rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në vlerën 552,263 lekë, për pagimin e këstit të tretë të apartamentit.

**Kësti i IV-të** – vlera 35,000 euro shlyer me kredi bankare.

**1.3.36** Subjekti deklaron se kësti i katërt është shlyer nëpërmjet kredisë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare me vlerë 35,000 euro.

**1.3.37** Nga hetimi rezultoi se ky këst është paguar me transfertë bankare nga Bankën Kombëtare Tregtare në llogarinë bankare të investitorit Y. S. .

---

<sup>27</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2021, të “Tirana Bank”.

**1.3.38** Trupi gjykues, në analizë të provave dhe fakteve të administruara, çmon se subjekti ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e këstit të katërt të apartamentit.

**Kësti i V-** në vlerën 22,770 euro ose 2,804,866 lekë, i cili është i parashikuar në kontratën e shitjes, rezulton se nuk është shlyer ende nga subjekti, deri në datën e zhvillimit të seancës dëgjimore.

Analiza dhe arsyetimi i bërë në këtë vendim, lidhur me elementin e çmimit të apartamentit, është relevante.

#### **1.4 Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të katit të tretë të banesës në rrugën “\*\*\*”**

**1.4.1** Subjekti deklaron gjatë hetimit<sup>28</sup> se për ndërtimin e tij si burim krijimi kanë shërbyer:

- a) të ardhurat nga paga, sipas ekzekutimit të vendimit<sup>29</sup> gjyqësorë të formës së prerë, ku vërtetohet se ka tërhequr shumën prej 1,351,043 lekësh, sipas mandatpagesës nr. \*\*\*, datë 28.12.2001;
- b) të ardhurat nga shitja e shtëpisë në Lushnje sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 2.9.2002, vlera e përfituar prej subjektit është gjysma e pagesës së shumës prej 1,200,000 lekësh; si dhe
- c) kursimet familjare.

**1.4.2** Në analizë të burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, Komisioni vlerësoi së pari vlerën e këtij ndërtimi në raport me deklaratimet e subjektit dhe me kuadrin ligjor në fuqi. Lidhur me çmimin e referencës së katit të tretë të banesës në rrugën “\*\*\*”, Tiranë, nga hetimi rezultoi se subjekti ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit të dorëzuar në datën 10.11.2006, pranë ALUIZNI-t, se viti i ndërtimit është 10.9.2001, ndërkohë gjatë hetimit<sup>30</sup> subjekti shpjegoi se babai i tij ka blerë në datën 17.3.1997, pasurinë në rrugën “\*\*\*”. Ndërtimi i kryer prej subjektit nuk ka qenë i përfunduar në datën 10.9.2001, por në këtë periudhë ka filluar të hedhë kolonat për ndërtimin e katit të tretë me shkallë të veçanta për në këtë kat. Në DIPP-në të vitit 2004, subjekti ka deklaruar datën e krijimit më 1.11.2001.

**1.4.3** Komisioni, në analizë të këtyre deklaratimeve kontradiktore, vendosi:

- a) Në përcaktimin e kohës së ndërtimit të jetë data e deklaruar në formularin e vetëdeklarimit të ALUIZNI-t, e cila përputhet me deklaratimin në DIPP-në të vitit 2004.
- b) Komisioni, në përcaktimin e sipërfaqes së këtij ndërtimi, konstatoi se në formularin e vetëdeklarimit të dorëzuar pranë ALUIZNI-t ka deklaruar sip. ndërtimi 140 m<sup>2</sup>. Edhe në deklaratën noteriale të nënshkruar me z. E. K. deklarohet sip. e ndërtimit 160 m<sup>2</sup>, ndërsa në certifikatën e pronësisë të lëshuar në datën 14.10.2016, sip. e katit të dytë (kati i tretë i ndërtimit) është 131.3 m<sup>2</sup>+ 22.4 m<sup>2</sup>, pra, totali me sip. 153.7 m<sup>2</sup>.

**1.4.4** Në analizë të provave të sipërpërmendura, Komisioni do të konsiderojë në analizën e tij si sipërfaqe ndërtimi të katit të tretë të banesës, sip. 153.7 m<sup>2</sup>.

<sup>28</sup>Shihni përgjigjen nr. 4c, në pyetësin nr. 2.

<sup>29</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2017, të Prokurorisë së Përgjithshme, përcjellë me pyetësin nr. 2.

<sup>30</sup>Shihni përgjigjen nr. 2, në pyetësin nr. 3.

**1.4.5** Në lidhje me koston e ndërtimit të katit të tretë, është analizuar vlera e deklaruar me koston e ndërtimit në këtë vit sipas referencave me EKB-së. Në lidhje me koston e ndërtimit sipas EKB-së së vitit 2001<sup>31</sup>, në Tiranë, rezulton se kosto e katit të tretë është  $28,641 \text{ lekë/m}^2 * 153.7 \text{ m}^2 = 4,402,122 \text{ lekë}$ . Duke zbritur vlerën e TVSH (20%), sepse punimet e ndërtimit janë bërë nga vetë subjekti dhe nga vëllezërit e tij, rezulton kosto e ndërtimit në vlerën 3,521,697 lekë. Kjo vlerë është më e ulët se vlera e deklaruar e shitjes së katit të tretë, z. E. K., me deklaratën noteriale me vlerë 6,900,000 lekë. Gjithashtu, vlera e shitjes është 196% më të lartë se kosto e ndërtimit.

**1.4.6** Sa më sipër, subjektit iu kalua barra e provës, lidhur me faktin, se duket e dyshimtë shitja e pasurisë me vlerë shumë më të lartë se kostoja e ndërtimit, në marrëdhënie të tilla të posaçme si ajo midis vëllezërve kur përgjithësisht trajtohen më çmime preferenciale.

**1.4.7** Lidhur me këtë konstatim, subjekti shpjegoi se: *“Komisioni ka përllogaritur koston e ndërtimit sipas EKB-së së vitit 2001 në Tiranë në vlerën 28,641 lekë/m<sup>2</sup> për sipërfaqen 153.7 m<sup>2</sup>. Në fakt sipërfaqja është 131.3 m<sup>2</sup> + 22.4 m<sup>2</sup> që janë shkallët, të cilat nuk mund të përllogariten me të njëjtën kosto që është edhe ndërtimi i shtëpisë. Referuar fotografive në raportin e vlerësimit shkallët kanë qenë të hapura, madje edhe pa kangjella sikurse janë në foto sot dhe njëkohësisht të pashtruara. Vlera e metrit katror të shkallëve nuk mund të përllogaritet me të njëjtën kosto sikurse është për metrin katror të ndërtesës. Edhe sot nëse i ndërton ato shkallë nuk mund të kushtojnë më shumë se gjysma e vlerës që përllogarit Komisioni në vitin 2001.*

*Gjithashtu, Komisioni, vlerës që rezulton nga përllogaritja, i ka zbritur vetëm vlerën 20% të TVSH-së. Ndërkohë duhet të zbriten fondi rezervë, fitimi në ndërtim 7%, koston e projektimit dhe marrjes së lejes së ndërtimit, fuqia punëtore pasi edhe sipas deklarimeve kam shpjeguar se është ndërtuar nga vete në ( katër vëllezër dhe babai).*

*Nëse vlerës së përllogaritur nga Komisioni në shumën 3,521,697 lekë i zbresim vlerën për shkallët të cilat nuk duhet të përllogariten me të njëjtën kosto, si dhe të gjithë zërat e tjerë më lart, por edhe faktin se disa prej materialeve ishin gjendje nga ndërtimi i dy kateve të para, do të rezultojë se kosto e ndërtimit për katin e tretë nuk do të jetë më shumë se 2,000,000 lekë. Komisioni duhet të mbajë në konsideratë sikurse është deklaruar edhe prej meje në deklaratën sqaruese të vitit 2006 se kati i tretë nuk ka qenë tërësisht i përfunduar.*

*Subjekti përcjell në komision edhe raportin e vlerësimit të përgatitur nga inxhinier G. S. për ndërtesën me sip. 131.3 m<sup>2</sup>, në datën 3.4.2021. Sipas këtij dokumenti z. Avni Kraja zotëron katin e dytë teknik me sip. 131.3 m<sup>2</sup>, mbi të cilën bëhen llogaritjet nga vlerësuesi duke e konsideruar se në vitin 2001 kjo ndërtesë ka qenë karabina dhe kosto e saj është 50% e çmimit të referencës (kosto EKB). Më pas duke i zbritur edhe shpenzimet e tjera (5%) të tilla si shpenzime lidhje energjie elektrike, lidhje me rrjetin e ujësjellësit, për rrjetin e kanalizimeve rezulton se vlera reale e investimit rezulton të jetë 2,031,022 lekë”.*

---

<sup>31</sup>Referojuni udhëzimit nr. 5, datë 31.5.2001.

**1.4.8** Trupi gjykues, lidhur me përcaktimin e kostos së ndërtimit të kësaj banese, në analizë të legjislacionit në fuqi, jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, provave dhe fakteve të administruara, çmon se pretendimet e subjektit nuk janë të bazuara.

**1.4.9** Lidhur me burimin e ligjshëm të deklaruar për realizimin e këtij ndërtimi, Komisioni vëren se:

a) Data e ndërtimit sipas formularit të vetëdeklarimit pranë ALUIZNI-t është më 10.9.2001, ndërsa data e shumës së tërhequr nga vendimi i gjykatës është bërë me mandatpagesën e datës 28.12.2001. Pra, shuma është tërhequr më pas datës së deklaruar të përfundimit të ndërtimit, duke e përjashtuar si burim krijimi këtë vlerë për ndërtimin e katit të tretë në banesën në rrugën “\*\*\*\*”.

b) Gjithashtu, Komisioni ka konsideruar të përpjesëtuar në mënyrë të barabartë midis të gjithë bashkëpronarëve në moshë madhore në datën 1.12.1992, sipas kërkesave të ligjit nr. 7652 datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, vlerën e shitjes së apartamentit në Lushnjë. Pra, edhe pse subjekti deklaroi se ka përfituar gjysmën e pagesës prej 1,200,000 lekësh, në analizë është marrë në konsideratë 1/5 e pagesës për këtë apartament, si e përfituar nga subjekti i rivlerësimit (240,000 lekë), pasi nuk kemi asnjë akt provues se pjesa tjetër e bashkëpronarëve ka hequr dorë nga pjesa takuese e tyre.

Në lidhje me këtë vlerë, rezulton se kontrata e shitjes së apartamentit në Lushnjë është nënshkruar në datën 2.9.2002, pra, gati një vit pas deklarimit të ndërtimit (më 10.9.2001). Për më tepër, nuk rezulton asnjë provë se pagesa e mësipërme është realizuar në kohën e ndërtimit, pra, një vit më herët.

**1.4.10** Nga hetimi rezultoi se nuk justifikohet dhe, për pasojë, nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni burimi i krijimit të deklaruar nga subjekti në pikat (a) dhe (b).

**1.4.11** Subjekti deklaroi se si burim për krijimin e pasurisë janë përdorur kursimet familjare. Komisioni hartoi analizën financiare për përdhën 1.8.1992 – 2000, për të hetuar mbi mundësinë e subjektit mbi kursimin, në periudhën para ndërtimit të katit të tretë.

Periudha	1.8.1992 – 2000 (vlera në lekë)
Të ardhura të subjektit të dokumentuara të periudhës	1 341 874
Shpenzime jetike	826 483
Blerja e truallit në rrugën “****”, Tiranë	250 000
Pagesat ndaj EKB-së për apartamentin në Lushnjë	51 893
Rezultati i analizës financiare/(mundësia për të kursyer)	265 391

**1.4.12** Në mënyrë të përmbledhur, analiza e burimit të krijimit për banesën në katin e tretë në rrugën “\*\*\*\*” është pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Burimi i krijimit për katin e tretë në banesën në rrugën “***”	Vlerat në lekë sipas deklarimit	Konsideratat e Komisionit si burim krijimi
Të ardhurat nga vendimi i gjykatës si dëmshpërblim	1,351,043	Komisioni nuk e ka përfshirë në analizë si burim krijimi sepse data e marrjes së dëmshpërblimit është e mëpasshme nga data e deklarimit të ndërtimit.
Të ardhurat nga shitja e ap. në Lushnjë	600,000	Nuk është përfshirë në analizë si burim krijimi sepse kontrata e shitjes është realizuar në vitin 2002, gati një vit pas përfundimit të ndërtimit.
Mundësia për të kursyer për periudhën 1992 – 2000	e padeklaruar por rezulton nga llogaritjet të jetë në vlerën 48,957	Nga analiza e Komisionit rezulton se mundësia për të kursyer përpara periudhës së ndërtimit e subjektit është në vlerën 265,391 lekë
<b>Totali i vlerës së investimit sipas deklarimit të subjektit</b>	<b>2,000,000</b>	<b>Në referencë me koston e EKB-së rezulton se pamundësia e subjektit për realizimin e ndërtimit është në vlerën 3,521,697 lekë.</b>

**1.4.13** Sa më sipër, Komisioni i dërgoi subjektit barrën e provës, duke konstatuar se rezulton në pamundësi financiare në shumën prej 3,521,697 lekësh.

**1.4.14** Subjekti, pas dërgimit të barrës së provës, shpjegon se: *“Komisioni duhet të mbajë në konsideratë në analizën financiare edhe shumën e marrë nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor, datë 28.12.2001, në shumën 1,351,043 lekë, si dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit në Lushnjë. Unë kam deklaruar se ndërtimi i shtëpisë së banimit është në datën 10.9.2001, por jo i katit të tretë. Punimet në katin e tretë kanë filluar përpara kësaj date dhe kanë vazhduar në pjesën më të madhe të tyre edhe pas datës 10.9.2001. Unë nuk kam pasur mundësi të tjera të ardhurash pasi marrëdhëniet e punës ishin shkëputur që prej tetorit të vitit 1998. Me kursimet që kisha deri në atë moment fillova ndërtimin e katit të tretë. Pasi u njoha me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.10.2001 dhe çështja mori formë të prerë kam vazhduar ndërtimin e katit të tretë me ritme të larta. Me të ardhurat e marra nga ekzekutimi i vendimit kam bërë edhe shlyerjen e detyrimeve që kisha për ndërtimin. Gjithashtu, edhe për apartamentit në Lushnjë unë deklaroj me përgjegjësi të plotë se vlera është arkëtuar përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes. Për shkak të kohës së largët që ka kaluar nuk mund të arrij të gjej aktin noterial që kemi firmosur në vitin 1997. Që prej vitit 1997 deri më 2.9.2002, apartamenti i Lushnjës ka qenë i banuar nga blerësit. Kontrata e shitjes është nënshkruar mbasi në kishim nënshkruar kontratën me Entin e Banesave në datë 26.8.2002.*

*E kam disponuar deri vonë aktin noterial që kishim nënshkruar me blerësit në vitin 1997, por nuk kam arritur të siguroj një kopje të saj në arkivën e noterit në Lushnjë edhe pasi kam shkuar disa herë atje. Po kështu, blerësit e shiten apartamentin në vitin 2006 dhe kanë emigruar në Itali dhe nuk kam pasur mundësi kontakti me ta.*

*Komisioni duhet të marrë në konsideratë në analizën financiare shumën sipas ekzekutimit të vendimit, pasi ishte ai vendim që më bëri të vazhdoja me ritme të larta punimet e katit të tretë. Gjithashtu, për shkak të kohës së largët që ka kaluar dhe pamundësisë së gjetjes së dokumenteve*

*ligjor nënshkruar në atë kohë duhet të kryejë analizën financiare në mënyre me gjithëpërfshirëse dhe jo aq strikte sa duhet të kryhet nga momenti i deklarimit për herë të parë dhe në vazhdim”.*

**1.4.15** Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit dhe pas dërgimit të barrës së provës, arrin në konkluzionin se si burim për të ardhurat për ndërtimin e katit të tretë të banesës në rrugën “\*\*\*\*”, nuk mund të shërbejnë burimet e deklaruara nga subjekti dhe, për pasojë, subjekti rezulton përfundimisht me një pamundësi financiare në vlerën 3,521,697 lekë.

Trupi gjykues, në analizë të harmonizuar të gjithë provave të administruara, çmon se lidhur me pasurinë apartamenti në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë:

- a) Subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2007 kontratën e sipërmarrjes të lidhur në datën 7.9.2007, për këtë pasuri.
- b) Subjekti nuk ka deklaruar shpenzime për kryerjen e punimeve të mbetura në apartamentin në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, të deklaruara në deklaratën e interesave private të vitit 2008. Gjithashtu, nuk provon me dokumentacion ligjor kryerjen dhe vlerën e tyre.
- c) Nuk provohet me dokumentacion ligjor shlyerja totale e vlerës së blerjes së apartamentit në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë dhe mospasja e detyrimeve të tjera nga palës shitëse të tij.
- d) Subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë vlerat dhe mënyrën e shlyerjes së kësteve të apartamentit në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë.
- e) Subjekti nuk ka deklaruar në DVP-të dhe as në deklaratën *Vetting*, pjesën takuese të ndërtesës 3 kate, me sip. 131.3 m<sup>2</sup>/kati, të ndodhur në Tiranë.
- f) Nuk u provua bindshëm dhe me dokumentacion ligjor se vlera e shitjes së katit të tretë të banesës në rrugën “\*\*\*\*” është burimi i pagesës 40,000 euro (kësti i parë më 4.9.2007). Gjithashtu, nuk provohet transferimi i vlerës 6,900,000 lekë për shitjen e banesës nga vëllai i tij tek subjekti i rivlerësimit.
- g) Konstatohet se subjekti me kontratën e datës 20.01.2020 ka shitur 1/5 e pjesës takuese të ndërtesës në rrugën “\*\*\*\*” dhe jo katin e tretë të saj.
- h) Rezulton e dyshimtë vlera e deklaruar prej 2.000.000 lekësh, për ndërtimin e katit të 3 të banesës në rrugën “\*\*\*\*” dhe shitja e saj në vitin 2007, në vlerën 6.900.000 lekë. Subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor vlerën e investuar në ndërtimin e katit të tretë.
- i) Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar koston e ndërtimit me referencë vlerën e konstatuar nga EKB-ë, pasi në analizën e Komisionit rezultoi me mungesë burimi financiar në vlerën 3,521,697 lekë.

**Në përfundim, për pasurinë apartamenti në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve në pikat 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.**

**2. Truall me sipërfaqe totale 398.8 m<sup>2</sup>**, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, lëshuar në datën 14.10.2016. Pjesa takuese: 1/5. Burimi i krijimit: nga toka e blerë nga babai D. K. . Përfitur si përfitues ligjor me pjesë takuese 1/5, ku vërtetohet nga vërtetimi i pronësisë së pronës së

regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. \*\*\*, datë 25.11.1995, e tokës me sipërfaqe 969 m<sup>2</sup> (blerë nga babai D. K., sipas kontratës së shitjes me nr. \*\*\*, datë 17.3.1997, me noter Dh.S. M.).

**2.1** Analiza e burimit të ligjshëm, dokumentacionit dhe trajtimit ligjor dhe financiar të kësaj pasurie, janë kryer në pasurinë më sipër.

**2.2** Për sa më sipër, për këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve në pikat 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

### **3. Gjendje cash në vlerën 1,450,000 lekë, në datën 29.1.2017**

**3.1** Subjekti deklaron në deklaratën *Vetting* gjendje *cash*, në vlerën 1.450.000 lekë, në datën 29.1.2017, duke deklaruar si burim të ardhurat nga puna që nga 1.8.1992 dhe e bashkëshortes që nga maj i vitit 2002 dhe deri më sot, si dhe të ardhura të përfituara nga shitja e apartamentit në lagjen “\*\*\*”, Lushnjë, përfituar si i pastrehë gjatë kohës së ushtrimit të detyrës si drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, vërtetuar me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 2.9.2002, mbi shitjen e një apartamenti të përbashkët me prindërit dhe dy vëllezërit. Pjesa takuese: 50%.

**3.2** Komisioni konstaton se gjendja *cash* e kursimeve më 31.12.2016, sipas deklarimeve në DIPP-të e viteve 2003 – 2016 rezulton të jetë në vlerën 2,500,000 lekë dhe jo 1,450,000 lekë sa ka deklaruar subjekti në deklaratën *Vetting*.

**3.3** Subjekti i pyetur gjatë hetimit<sup>32</sup> shpjegon, se: “*Gjendja cash në datën 31 dhjetor 2016 ka qenë në shumën 2,500,000 lekë. Në deklaratën Vetting kam deklaruar gjendjen cash në datën 29.1.2017, në shumën 1,450,000 lekë. Këto janë gjendjet e dy datave të ndryshme dhe arsyeja pse ndryshon vlera. Gjendja në 31 dhjetor 2016 ka qenë më e lartë krahasuar me gjendjen në datë 29 janar 2017*”.

**3.4** I pyetur nga Komisioni<sup>33</sup>, për të sqaruar mospërputhjen në deklaramet e tij midis deklaratës *Vetting* dhe përgjigjeve në pyetësorë<sup>34</sup>, subjekti sqaron se: “*Deklarimi nga ana ime në deklaratën Vetting mbi burimin e krijimit të gjendjes cash në datën 29.1.2017 ka qenë mbi faktin se kursimet nga paga ime që kur kam filluar punë për herë të parë dhe kursimet nga të ardhurat e pagës së bashkëshortes që prej maj 2002 kanë shërbyer si burim në krijimin e gjendjes cash. Gjithashtu, kam përmendur si burim krijimi edhe të ardhurat nga shitja e apartamentit në Lushnjë. Kam përshkruar në mënyrë narrative se si burim krijimi janë pikërisht kursimet e mia të deklaruara si shtim të gjendjes cash dhe kam vazhduar, më tej, me shitjen e apartamentit në Lushnjë. Kujtoj, në momentin e plotësimit të deklaratës se kam kërkuar të përfshijë edhe të ardhurat e tjera nga shitja e pasurive të luajtshme. Duket se është pasaktësi, pasi nuk ka bazë deklarami dhe logjike që të ardhurat nga shitja e shtëpisë të kenë shërbyer në mënyrë direkte në krijimin e gjendjes cash. Në burimin e krijimit të gjendjes cash në momentin e plotësimit të deklaratës kanë shërbyer kursimet nga paga ime dhe e bashkëshortes*”.

<sup>32</sup>Shihni pyetësorin nr. 3, përgjigjja nr.7.

<sup>33</sup>Shihni pyetësorin nr. 3, përgjigjja nr. 5a.

<sup>34</sup>Shihni pyetësorin nr. 2, datë 21.11.2020.



Gjithashtu, subjekti sqaron se: “Gjysma e të ardhurave nga shitja e apartamentit në Lushnjë në vlerën 1,200,000 lekë kanë shërbyer të gjitha për ndërtimin e katit të tretë në banesën e ndodhur në rrugën \*\*\*. Ndërkohë, shpjegoj se asnjë shumë të hollash, nga të ardhurat e shitjes së apartamentit në Lushnjë nuk ka shërbyer për krijimin e gjendjes cash”.

**3.5** Subjektit iu kalua barra e provës lidhur me faktin se nuk ka dhënë shpjegime bindëse mbi arsyet se pse ka ndryshuar në shumën 1,050,000 lekë, gjendja e kursimeve, nga deklarimi i DIPP-së për vitin 2016 plotësuar në datën 20.3.2017, me deklaratën *Vetting* plotësuar në datën 26.1.2017.

**3.6** Në përgjigje të barrës së provës, subjekti shpjegon se: “Gjendja cash i referohet dy momenteve të ndryshme kohore, diferenca në shumën 1,050,000 lekë është konsumuar për shpenzime të ndryshme të kryera në janar të vitit 2017”.

**3.7** Në përfundim, Komisioni konstaton se si pasojë e deklarimeve kontradiktore të subjektit në deklaratat periodike, në deklaratën *Vetting* dhe gjatë procesit të rivlerësimit, në drejtim të vlerës *cash* dhe ndryshimeve në vlerën e deklaruar, krijojnë pamundësinë për të verifikuar se cili prej deklarimeve të bëra është ai që pasqyron gjendjen reale të likuiditeteve *cash*, për pasojë, për të arritur në një konkluzion për të kontrolluar ligjshmërinë e krijimit të tyre, qëndrim ky i mbajtur edhe në Jurisprudencën e Kolegjit me vendim (JR) nr. 11, datë 3.7.2020.

**4. Llogari page në “Credins Bank”, me nr. llogarie \*\*\*, me gjendje llogarie më 26.1.2017, në shumën 73,604 lekë. Burimi: të ardhurat nga paga. Pjesa takuese: 100%.**

**4.1** Nga të dhënat e administruara gjatë hetimit rezultoi se informacioni për ekzistencën e kësaj llogarie rrjedhëse daton që nga nëntori i vitit 2010<sup>35</sup>, në të cilën subjektit i kalon paga që nga viti 2010 dhe në vijim.

**4.2** Trupi gjykues çmon se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”<sup>36</sup>, lidhur me këtë llogari bankare, si dhe subjekti ka deklaruar saktë gjendjen në “Credins Bank” dhe, po kështu, edhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e shumës 73,604 lekë në këtë llogari.

## **5. Deklarimi i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. A. K.**

**5.1 Llogari rrjedhëse nr\*\*\*, e pagës së bashkëshortes në BKT, hapur në vitin 2015, me gjendje më 27.1.2017, në shumën prej 186,153 lekë, krijuar me të ardhura nga paga. Pjesa takuese: 100%.**

**5.1.1** Shuma e deklaruar në deklaratën *Vetting* konfirmohet nga përgjigja e BKT-së. Nga të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se informacioni për ekzistencën e kësaj llogarie daton që nga 31.10.2007<sup>37</sup> dhe kjo është llogaria rrjedhëse, në të cilën subjektit i kalon paga që nga qershori i vitit 2015 dhe në vijim. Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e përcjellë në Komision<sup>38</sup>, si dhe bashkëshortja ka deklaruar saktë gjendjen në

<sup>35</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 30.9.2020.

<sup>36</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 30.9.2020.

<sup>37</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 30.9.2020.

<sup>38</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.6.2020, të BKT-së.

BKT dhe, po kështu, edhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e shumës 186,153 lekë në këtë llogari.

**5.2 Depozitë plus** me nr. klienti \*\*\*, në emër të bashkëshortes në “Credins Bank”, me gjendje më 26.1.2017, në vlerën 62,804 lekë. Burimi: të ardhurat nga paga. Pjesa takuese: 100%.

**5.2.1** Nga informacioni i administruar gjatë hetimit nga “Credins Bank”<sup>39</sup> rezulton se kjo llogari depozite është çelur nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në datën 25.9.2014, ku është transferuar nga llogaria e pagës në “Credins Bank” shuma prej 20,000 lekësh. Më pas, janë bërë disa transferta brenda llogarive të bashkëshortes së subjektit kryesisht në vitin 2014 dhe 2015. Përgjatë vitit 2014 janë bërë transferta brenda llogarive në vlerën totale 225,367 lekë dhe janë tërhequr nga llogaria vlera 188,036 lekë. Ndërsa në vitin 2015 janë bërë transfertë në llogarinë e depozitës 25,340 lekë. Gjendja e kësaj llogarie më 31.12.2016 ka qenë në shumën 62,619.93 lekë. Komisioni vlerëson se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar saktë gjendjen e depozitës në bankën “Credins Bank” dhe, po kështu, edhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e depozitës.

### **5.3 Depozita Kaltra në emër të fëmijëve të subjektit të rivlerësimit në “Credins Bank”**

**5.3.1 Depozitë Kaltra** në emër të djalit Jeton Kraja në “Credins Bank” me nr. \*\*\*, me gjendje më 27.1.2017, në vlerën 23,328 lekë. Pjesa takuese: 100%.

**5.3.2 Depozitë Kaltra** në emër të vajzës P. K. në “Credins Bank” me nr. \*\*\*, me gjendje më 27.1.2017, në vlerën 23,328 lekë. Pjesa takuese: 100%.

**5.3.3 Depozitë Kaltra** në emër të vajzës D. K. në “Credins Bank” me nr. \*\*\*, me gjendje më 27.1.2017, në vlerën 24,870 lekë. Burim: të ardhurat nga paga. Pjesa takuese: 100%.

Nga informacioni i administruar gjatë hetimit administrativ nga “Credins Bank” rezulton se të tria llogaritë depozite janë çelur nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në datën 25.9.2013. Vlerat e tyre janë krijuar nga transferta brenda “Credins Bank” nga llogaria e pagës së znj. A. K. me derdhje periodike dhe me të njëjtën vlerë për secilin prej fëmijëve.

Trupi gjykues çmon se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar saktë gjendjen e depozitave të fëmijëve në “Credins Bank” dhe, po kështu, edhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e tyre.

**5.4 Llogari në “Credins Bank”,** me nr\*\*\*, me gjendje më 27.1.2017, në vlerën 5.000 lekë me burim nga të ardhurat nga Njësia Bashkiake nr. 9, nga pagesat për shpërblim lindje. Pjesa takuese: 100%.

**5.4.1** Nga hetimi rezultoi se kjo është llogari me titullar P. K., në të cilën është derdhur shpërblimi i Bashkisë Tiranë për lindjen e fëmijës.

**5.4.2** Trupi gjykues çmon se gjendja në llogari përputhet me deklarimin e bashkëshortes.

---

<sup>39</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.9.2020.

**5.5 Llogari page në “Credins Bank”, me nr\*\*\*, me gjendje më 26.1.2017, në vlerën 132 lekë me burim të ardhurat nga paga. Pjesa takuese: 100%.**

**5.6 Shuma e mësipërme e deklaruar në deklaratën *Vetting* konfirmohet nga përgjigja e “Credins Bank”<sup>40</sup>. Nga të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se informacioni për ekzistencën e kësaj llogarie daton nga 2.5.2008<sup>41</sup> dhe është përdorur si llogari e pagës së bashkëshortes deri në vitin 2014.**

**5.7 Trupi gjykues çmon se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”<sup>42</sup>. Subjekti ka deklaruar saktë gjendjen në “Credins Bank” dhe, po kështu, edhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e shumës 132 lekë në këtë llogari.**

Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, për krijimin e pasurive monetare, si më sipër referuar në pikën 5, janë trajtuar si pjesë e analizës financiare për vitet 2003 – 2016, e cila është pasqyruar në vijim të vendimit.

## **GJETJE TË TJERA TË KOMISIONIT GJATË HETIMIT ADMINISTRATIV**

### **6. Lidhur me pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, truall me sipërfaqe 540 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë**

**6.1** Gjatë hetimit<sup>43</sup> Komisioni konstatoi se subjekti kishte në bashkëpronësi nga trashëgimia nga babai i tij me 1/5 pjesë takuese në pasurinë truall me sip. 540 m<sup>2</sup> me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në Tiranë, certifikuar më 10.7.2018.

**6.2** Nga komunikimi shkresor i Komisionit me ILDKPKI-në<sup>44</sup> rezulton se në DIPP-në e vitit 2019 subjekti ka deklaruar këtë pasuri, për të cilën deklaroi se nuk ka pasur dijeni më parë dhe prandaj nuk e ka deklaruar në DVP-në e vitit 2018.

**6.3** Rezulton nga sistemi dixhital i pasurive të paluajtshme se babai i subjektit ka fituar pasurinë më sipër me kontratë shitje, regjistruar në datën 31.10.2013. Gjithashtu, konstatohet se babai i subjektit ka ndërruar jetë në vitin 2014 dhe në këtë vit është çelur dhe dëshmia e trashëgimisë ligjore.

**6.4** Sa më sipër, subjektit iu kalua e barrës së provës lidhur me faktin se duket e dyshimtë padijenja e tij lidhur me fitimin e kësaj pasurie nga babai i tij, përpara datës 10.7.2018, datë e certifikimit të saj.

**6.5** Lidhur me këtë barrë prove, subjekti i rivlerësimit nuk dha asnjë shpjegim as gjatë procesit, as pas dërgimit të barrës së provës dhe as në seancë dëgjimore.

**6.6** Në përfundim, Komisioni konstaton, se si pasojë e mungesës së parashtrimeve rreth barrës së provës së dërguar, ka pamundësinë për të verifikuar dhe, për pasojë, për të arritur në një konkluzion

<sup>40</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 30.9.2020.

<sup>41</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.9.2020.

<sup>42</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\*prot., datë 30.9.2020.

<sup>43</sup>Kjo pasuri rezultoi në regjistrin dixhital të pasurive të paluajtshme IPS.

<sup>44</sup>Shkresa nr. \*\*\*, datë 8.1.2021.

për të kontrolluar ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie, qëndrim ky i mbajtur edhe në Jurisprudencën e Kolegjit me vendim (JR) nr. 11, datë 3.7.2020.

**7. Komisioni konstatoi se në deklaratën *Vetting* subjekti nuk deklaroi automjete apo transaksione shitblerje të kryera gjatë viteve me to, por konstatoi blerje dhe shitje të automjeteve në deklaratat periodike të interesave private të viteve 2003 – 2016, të cilat analizohen si vijon:**

**7.1 Automjet tip “Mercedes-Benz 250”, me ngjyrë gri, me targa \*\*\*, blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 23.7.2002, në vlerën 60,000 lekë. Burimi i krijuar me të ardhura nga paga. Pjesa takuese: 100%.**

**7.1.1** Pasuria rezulton të jetë deklaruar nga subjekti në Deklaratën Periodike të Interesave Private të vitit 2003, në të cilën ka deklaruar automjet tip “Mercedes-Benz 250”, ngjyrë gri, me targa \*\*\*. Subjekti në Deklaratën e Interesave Private dhe Periodike të vitit 2008 ka deklaruar se ka shitur automjetin tip “Mercedez-Benz”, në vitin 2004, në vlerën 600,000 lekë, të cilin ka harruar ta deklarojë në vitin përkatës.

**7.1.2** DPSHTR<sup>45</sup>-ja nuk përcjell informacion bashkëlidhur praktikës së dërguar në Komision në lidhje me këtë automjet.

**7.1.3** Përgjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka deklaruar<sup>46</sup> se ky automjet i është shitur shtetasit Sh. D. sipas kontratës së shitblerjes të datë 7.5.2007, në vlerën 200,000 lekë. Lidhur me automjetin me targa \*\*\*, subjekti sqaron se e ka blerë sipas kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 23.7.2002, me palë shitëse Gj. M. . Vlera e blerjes së automjetit referuar kontratës është 200,000 lekë.

**7.1.4** Lidhur me burimin e ligjshëm, subjekti ka deklaruar në Deklaratën Periodike të Interesave Private të vitit 2003 për krijimin e kësaj pasurie pagën dhe gjatë procesit të rivlerësimit ka deklaruar se si burim për blerjen e automjetit me targa \*\*\* kanë shërbyer të ardhurat nga paga sipas ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë në shumën prej 1,351,043 lekësh.

**7.1.5** Lidhur me analizën e burimit të krijimit të pasurisë referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni hartoi analizën financiare të paraqitur në tabelën si vijon:

<b>Periudha</b>	<b>Korrik 2002 (vlera në lekë)</b>
Të ardhura të subjektit të dokumentuara të periudhës	343,820
Shpenzime jetike	54,754
Blerja e automjetit tip “Mercedes- Benz 250”	200,000
Shpenzime mobilimi, arredimi për banesën në rrugën “***”	250,000
<b>Rezultati i analizës financiare</b>	<b>(160,934)*</b>

<sup>45</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.6.2020, e DPSHTRR-së.

<sup>46</sup>Shihni pyetësorin nr. 2, përgjigja nr.VI.1.

Konsiderata për analizën e paraqitur në tabelën e mësipërme:

\*Subjekti gjatë hetimit (pyetësi nr. 2) ka ndryshuar burimin e deklarimit nga “paga” në “të ardhurat sipas ekzekutimit të vendimit gjyqësorë të formës së prerë”. Në analizën e mësipërme është marrë në konsideratë deklarimi në DPV-në e vitit 2003 ku deklarohet burim krijimi “paga”.

**7.1.6** Gjithashtu, subjekti ka ndryshuar qëndrimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit, duke shpjeguar se të ardhurat nga ekzekutimi i vendimi i gjykatës si dëmshpërblim për marrëdhënien e punës kanë shërbyer herë për krijimin e katit të tretë në banesën në rrugën “\*\*\*” dhe herë si burim krijimi i automjetit të lartpërmendur.

**7.1.7** Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit duke konstatuar se ka pamundësi financiare të krijojë pasurinë e mësipërme apo të kryente shpenzimet e tjera të deklaruara për këtë vit, me të ardhurat të ligjshme duke rezultuar në mungesë të ardhurash në shumën prej 160,934 lekësh.

**7.1.8** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit shpjegon: *“Sqaroj se të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit të gjykatës nuk u përdoren tërësisht për ndërtimin e katit të tretë. Komisioni ka marrë në analizë se pjesa takuese e të ardhurave nga shitja e apartamentit në Lushnjë është 240,000 lekë ose 1/5, ndërkohë kur përllogarit shpenzimet për blerjen i ngarkon 100% ato vetëm në analizën time financiare. Në fakt, të ardhurat e apartamentit në Lushnjë kanë qenë 600,000 lekë, pasi unë kam marrë gjysmën e vlerës së apartamentit. Arsyeja pse blemë apartamentin në Lushnjë ishte për shkak të transferimit tim me punë në këtë qytet. Duke përllogaritur si burimi krijimi shumën 600,000 lekë, mundësinë e kursimit deri në fund të vitit 2002, si dhe një pjese e të ardhurave nga ekzekutimi i vendimit do të rezultojë se tejkalohet shuma e investimit prej 2,000,000 lekësh. Në këtë kuptim të ardhurat nga vendimi gjykatës nuk janë destinuar 100% për krijimin e katit të tretë, por një pjese e vogël e tyre kanë shërbyer edhe në vitin 2002. Shpjegimet e mia kanë qenë më se të qarta pavarësisht faktit se nuk janë marrë në konsideratë në rezultatin paraprak të hetimit nga ana e Komisionit. Analiza financiare ka vazhduar në metodologjinë e ndjekur nga Komisioni dhe jo sipas fakteve dhe shpjegimeve të dhëna prej meje”.*

**7.1.9** Gjithashtu, subjekti shpjegon se: *“Analiza financiare deri në korrik të vitit 2002 prodhon një rezultat negativ në shumën 160,934 lekë, sipas përllogaritjeve dhe vlerave të marra nga vete Komisioni në analizë. Shpenzimet e arredimit janë konsideruar në shumën 250,000 lekë deri në korrik të vitit 2002, ndërkohë unë nuk kam deklaruar se gjysma e shpenzimeve janë kryer në gjashtë mujorin e parë dhe gjysma tjetër në periudhën e mbetur. Komisioni nuk më ka pyetur se kur është kryer shpenzimi i arredimit deklaruar prej meje në shumën 500,000 lekë. E gjej jo të drejtë shpërndarjen e shpenzimeve të mobilimit në një kohë kur unë nuk e kam deklaruar këtë fakt. Komisioni nuk duhet të përfshijë në analizën financiare shpenzimet e mobilimit në shumën 250,000 lekë. Ato duhet të konsiderohen në analizën vjetore të vitit 2002, për sa kohë nuk ka një deklarim ndryshe nga ana ime. Analiza financiare deri në korrik të vitit 2002 përmbyset nëse nuk përfshihet zëri i padeklaruar prej meje i kryer në këtë periudhë”.*

**7.1.10** Komisioni, duke konsideruar praktikën e tij dhe në kushtet e mungesës së deklaramit të datës së saktë të kryerjes së shpenzimeve të arredimit, ka shpërndarë në mënyrë të barabartë këtë shpenzim gjatë gjithë vitit 2002.

**7.1.11** Në përfundim, trupi gjykues çmon se si pasojë e deklaramive kontradiktore të subjektit në deklaratat periodike, deklaratën *Vetting* dhe gjatë procesit të rivlerësimit, në drejtim të vlerës *cash* dhe ndryshimeve në vlerën e deklaruar, krijojnë pamundësinë për të verifikuar se cila prej deklaramive të bëra është ai që pasqyron burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë.

**7.2** Për sa më sipër, për këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve në pikat 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

**8. Automjet tip “Volkswagen”, me targa \*\*\***, përfituar me kontratë nr\*\*\*, datë 18.2.2015, në vlerën 200,000 lekë, krijuar me të ardhura nga paga. Subjekti ka deklaruar se pas blerjes ka shpenzuar shumën 300,000 lekë për rregullimin e saj. Gjithashtu, ka deklaruar shitjen nga bashkëshortja sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 10.12.2015, të automjetit me targa \*\*\*, në shumën 10,000 euro.

**8.1** Në deklaratën periodike të interesave private vjetore të vitit 2015, subjekti ka deklaruar blerje automjeti tip “Volkswagen”, me targa \*\*\*, në shumën 200.000 lekë me kontratë nr. \*\*\*, datë 18.2.2015. Pas blerjes u shpenzua shuma prej 300.000 lekësh për rregullimin e saj. Gjithashtu, ka deklaruar shitjen e automjetit me targa \*\*\*, në shumën 10,000 euro, me kontratën nr\*\*\*, datë 10.12.2015, nga bashkëshortja.

**8.2** Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar gjatë hetimit se automjeti brenda vitit është blerë në vlerën 200,000 lekë + 300,000 lekë (rregullime) dhe më pas është shitur në vlerën 10,000 euro. Pra, kostoja është 500,000 lekë dhe është shitur 10,000 euro, të cilat të konvertuara në lekë janë në shumën 1,376,500 lekë.

**8.3** Subjekti, lidhur me vlerën e blerjes, riparimeve dhe shitjes së automjetit, me targa \*\*\*, ka shpjeguar<sup>47</sup> *se automjeti është blerë në logjikën e ekonomisë së tregut dhe ka vlerësuar se është blerje e leverdishme dhe nuk ka pasur qëllim shitjen e saj, por gjatë përdorimit, automjeti shfaq probleme dhe pala blerëse nisur nga viti i prodhimit 2008 e pëlqeu dhe e bleu.* Subjekti i bashkëlidh shpjegimeve të tij edhe faturën tatimore të datës 27.3.2015, të lëshuar nga servisi me vlerë totale 300,000 lekë.

**8.2.1** Lidhur me burimin e ligjshëm, Komisioni analizoi si vijon:

Në Deklaratën e Interesave Private Periodike të Vitit 2015, subjekti nuk deklaroi burimin e krijimit të kësaj pasurie. Gjithashtu, nuk deklaroi as pakësim kursimesh në këtë vit, të cilat mund të jenë përdorur si burim krijimi për automjetin. Me qëllim hetimit e mundësisë për të krijuar këtë pasuri,

---

<sup>47</sup>Shihni pyetësorin nr. 2.

Komisioni ka marrë në konsideratë si burim krijimi të ardhurat e vitit 2015, deri në momentin e blerjes së automjetit (më 18.2.2015), të cilat i ka paraqitur në analizën financiare të mëposhtme.

<b>Periudha</b>	<b>1.2.2015</b> (vlera në lekë)
Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit	110 173
Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit	50 258
Shpenzime për kredinë e marrë në BKT	51 879
Shpenzime jetese	93 448
Shpenzime shkollimi për fëmijët në shkollë jopublike	20 000
Blerja e automjetit tip “ Golf”, me targa ***	200 000
Likuiditet në bankë	282,461
<b>Rezultati i analizës financiare</b>	<b>(487 358)</b>

**8.2.2** Në lidhje me shitjen e automjetit me kontratën nr. \*\*\*, datë 10.12.2015, nga bashkëshortja në shumën 10,000 euro nga komunikimet me DTP<sup>48</sup>-në nuk rezulton të jetë paguar tatimi mbi të ardhurat për diferencën e çmimit të blerjes+shpenzimet e kryera, me çmimin e shitjes. Për pasojë, nuk është përfshirë si e ardhur vlera e shitjes së automjetit në analizën financiare të Komisionit.

**8.2.3** Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për pamundësinë financiare të krijimit të pasurisë në vlerën 487,358 lekë dhe dyshimeve të ngritura në lidhje me vlerën e shitje/blerjes së automjetit me targa \*\*\*, në vitin 2015, pasi brenda vitit është blerë në vlerën 200.000 lekë + 300.000 lekë (riparime) dhe është shitur më shtrenjtë, në vlerën 10.000 euro.

**8.2.4** Pas kalimit të barrës së provës subjekti shpjegon: “Në lidhje me konstatimin e Komisionit se ka dyshime lidhur me vlerën e shitjes/blerjes së automjetit me targa \*\*\*, në vitin 2015, pasi brenda vitit është blerë në vlerën 500,000 përfshirë riparimet dhe është shitur në vlerën 10,000 euro, sqaroj Komisionin sikurse e kam shpjeguar në pyetësor ky ishte një rast okazion. Blerja në vlerën 200,000 lekë u krye prej meje, pasi miku im i familjes kishte për pjesë një makine të ngjashme me makinën e blerë dhe më mori përsipër rregullimin. Ishte rastësia që disponohej një makinë tjetër për pjesë dhe vlera e blerjes pas riparimeve shkoi gjithsej në 500,000 lekë. Unë nuk e bleva dhe e rregullova makinën për ta shitur, por për ta përdorur për nevoja familjare. Por gjatë kohës së përdorimit filloj probleme konsumi dhe jo vetëm. Për këtë arsye e kam shitur, vlera e tregut të makinës nuk mund të ishte kurrsesi 500,000 leke, pasi nëse makina do të ishte në vlerë të tillë unë nuk do të isha munduar të blija një makinë jo në gjendje pune dhe ta riparoja nga çmimi i tregut për këtë tip automjeti në vitin 2015 ka qenë minimalisht 10,000 euro”.

Në lidhje me sa më sipër me burimin e ligjshëm të deklarimit, subjekti shpjegon: “Në lidhje me analizën financiare kryer prej Komisionit deri në momentin e blerjes së automjetit në datën 18.2.2015, e kundërshtoj atë për arsye se:

<sup>48</sup>Shihni shkresën nr\*\*\* prot., datë 2.6.2020.

a) Komisioni konstaton se unë nuk kam deklaruar pakësim kursimesh në këtë vit të cilat mund të jenë përdorur si burim krijimi për automjetin. Në këto kushte, analiza financiare është kryer për periudhën 1.1.2015 – 18.2.2015, vetëm për të ardhurat e realizuara nga pagat dhe shpenzimet e kryera. Kjo analizë e kryer në këtë mënyrë është e padrejtë. Në DIPP-në e vitit 2015 deklarohet gjendja cash në datën 31.12.2015. Fakti se nuk kam deklaruar pakësim të gjendjes cash nuk tregon se gjendja e kursimeve cash nuk mund të ketë shërbyer për blerjen e automjetit. Kursimet cash kanë shërbyer në datën 18.2.2015, për blerjen e automjetit dhe pakësimi i gjendjes cash në këtë datë është kompensuar me shtesat për periudhën tjetër vijuese duke prodhuar në fund të vitit 2015 një shtesë të gjendjes cash në shumën 500,000 lekë. Është alogjike që nga njëra anë të disponosh gjendje cash nga kursimet në shumën 2,000,000 lekë dhe nga ana tjetër të rezultosh me një balancë negative në shumën 487,358 lekë. Kur kursimet cash mund të kenë shërbyer si për blerjen e automjetit por edhe për përbalimin e shpenzimeve të tjera të kryera deri në atë periudhë apo për shtimin e likuiditeteve në bankë”.

Subjekti me shpjegimet parashtron edhe analizën financiare të krijimit të pasurisë sipas së cilës rezulton se ka mundësi për krijimin e pasurisë dhe rezultati në fund të vitit është në shumën 1,512,642 lekë.

**8.2.5** Komisioni mbështetur në praktikën e tij, çmon se do të konsiderohej si burim edhe gjendja cash në vitin paraardhës (më 31.12.2014), vetëm nëse subjekti do ta kishte deklaruar pakësimin e saj me qëllim blerjen e automjetit të mësipërm. Në këto kushte shpjegimet e subjektit nuk janë provuese dhe nuk janë reflektuar në analizën financiare të Komisionit.

**8.3** Për sa më sipër, për këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se ka bërë deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve në pikat 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenet 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

**9. Të ardhura në vlerën 250,000 lekë nga shitja e automjetit me targa \*\*\*, deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2007.** Burimi i krijimit janë të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Golf”, të ardhurat dhe kursimet nga paga, si dhe gjendja e kursimeve nga viti i kaluar.

**9.1** Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka deklaruar në DIPP-të, ndër vite, blerjen e automjetit tip “Opel Zafira”, me targa \*\*\* dhe burimin e krijimit të saj.

**9.2** Subjekti, i pyetur nga Komisioni<sup>49</sup> lidhur me arsyen e mosdeklarimit në deklaratat vjetore të blerjes së këtij automjeti dhe burimin e tij, ka shpjeguar se<sup>50</sup>: “... automjeti tip ‘Opel Zafira’ është blerë sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 25.10.2005. Vlera e blerjes së automjetit sipas kontratës ka qenë 250,000 lekë”. Subjekti pranon konstatimin e Komisionit dhe sqaron se ka qenë harresë prej tij për deklarimin e këtij automjeti në vitin 2005. Ka deklaruar vetëm shitjen e automjetit tip “Golf” me benzinë dhe nuk ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Opel Zafira”, ndërkohë sipas kontratës datë 6.3.2007 këtë automjet ia ka shitur shtetasit F. C., në vlerën 200,000 lekë. Si burim

<sup>49</sup>Shihni përgjigjen nr. V.2, në pyetësorin nr. 2.

<sup>50</sup>Bashkëlidhur me përgjigjet përcjell kontratën e shitjes së automjetit tip “Golf”, me targa \*\*\*, nënshkruar më 22.9.2005, ndërsa kontrata e blerjes së automjetit tip “Opel Zafira” është nënshkruar më 25.10.2005.



krijimi për blerjen e automjetit tip “Opel Zafira” kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Golf” sipas kontratës së shitblerjes nr\*\*\*, datë 22.9.2005, në shumën 200,000 lekë dhe diferenca në vlerën prej 50,000 lekësh ka si burim krijimi të ardhurat dhe kursimet nga paga dhe gjendja nga viti i kaluar”. Ndërsa i pyetur gjatë hetimit<sup>51</sup> deklaroi se si burim krijimi për blerjen e automjetit tip “Opel Zafira” kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Golf” në shumën 200,000 lekë dhe diferenca prej 50,000 lekësh ka si burim krijimi të ardhurat dhe kursimet nga paga.

**9.3** Komisioni konstaton se subjekti mund të ketë përdorur të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Golf” me targa \*\*\* dhe të ardhurat e vitit (në vlerën 50,000 lekë) për blerjen e automjetit tip “Opel Zafira”, me targa \*\*\*.

**9.4** Gjithashtu, rezulton se gjatë hetimit subjekti nuk ka përcjellë kontratën e blerjes dhe nuk ka deklaruar as në DIPP-të ndër vite dhe as gjatë hetimit burimin e krijimit të automjetit me targa \*\*\*.

Komisioni, me qëllim të hartimit të analizës financiare për të parë mundësinë e krijimit të kësaj pasurie, konsideroi si burim të ardhurat deri në shtator të vitit 2004. Analiza financiare e pasurisë është paraqitur në tabelën vijuese.

<b>Periudha</b>	<b>Janar 2004 - 1.9.2004</b> (vlera në lekë)
Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit	575 126
Shpenzime jetese	250 304
Blerja e automjetit tip “Volkswagen GOLF”, me targa ***	700 000
<b>Rezultati i analizës financiare</b>	<b>(375,178)</b>

**9.5** Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës pasi rezulton se nuk ka pasur mundësi të krijojë pasurinë e mësipërme (automjetin tip “Volkswagen GOLF”) apo të kryente shpenzimet e tjera të deklaruara për këtë periudhë me të ardhura të ligjshme duke rezultuar në mungesë të ardhurash prej 375,178 lekësh.

**9.6** Pas dërgimit të barrës së provës, subjekti përcjell, në lidhje me këtë pasuri, kontratën e shitblerjes datë 22.4.2004, në të cilën ble nga shtetasi M. D. automjetin tip “Volkswagen Golf”, me targa \*\*\*, në vlerën 200,000 lekë. Duke u konsideruar kjo provë nga Komisioni, rezultati financiar në vitin 2004 rezulton me balancë pozitive prej 320,130 lekësh dhe analiza e krijimit të pasurisë është si vijon:

<b>Periudha</b>	<b>Janar 2004 - 1.9.2004</b> (vlera në lekë)
Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit	575 126
Shpenzime jetese	250 304
Blerja e automjetit tip “Volkswagen GOLF”, me targa ***	200 000
<b>Rezultati i analizës financiare</b>	<b>124,822</b>

<sup>51</sup>Shihni përgjigjen nr. V.2, në pyetësorin nr. 2.

**9.7** Komisioni konstatoi se në lidhje me shitjen e automjetit tip “Volkswagen Golf”, me targa \*\*\*, subjekti, me barrën e provës, ka përcjellë një tjetër kontratë<sup>52</sup> (të re) në Komision për shitjen e tij. Ndërsa me pyetësonin nr. 2 është përcjellë prej tij një kontratë<sup>53</sup> për shitjen e këtij automjeti me të njëjtën vlerë, por me shtetas tjetër dhe datë tjetër (pika 9.2).

**9.8** Komisioni, në seancën dëgjimore, e pyeti subjektin pasi gjatë hetimit rezultoi se për automjetin tip “Volkswagen Golf”, janë depozituar 2 kontrata shitjeje. Kontrata e shitjes e datës 12.5.2006 para noteres M. D., shitur shtetas E. D., e depozituar nga subjekti pas barrës së provës. Ndërkohë, gjatë procesit të rivlerësimit, ka rezultuar një kontratë tjetër shitjeje, pikërisht e datës 22.9.2005, ku subjekti po të njëjtin automjet ia shet shtetasit A. M. pranë noteres S. B. .

**9.9** Subjekti përgjigjet lidhur me këtë konstatim se: *“Dokumentacioni që kam marrë dhe kam paraqitur përpara jush e nderuar, është marrë me vulë të njomë në DPSHTRR. Nisur nga pyetjet që janë bërë, unë i jam drejtuar DPSHTRR-së dhe aty kam marrë kontratat që janë të depozituara”*.

**9.10** Në seancë dëgjimore subjekti u ripyet lidhur me faktin se cila është kontrata që ka lidhur dhe, për pasojë, personi që i ka shitur automjetin, duke qenë se të dyja këto kontrata rezultojnë të nënshkruara prej tij. Në përgjigje, subjekti shpjegon se: *“Nuk e mbaj mend këtë pjesë”*.

**9.11** Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se, pavarësisht analizës financiare pozitive një element relevant në procesin e rivlerësimit të subjektit, është pikërisht konstatimi i dy kontratave me të njëjtin objekt dhe me dy persona të ndryshëm, gjë e cila përveçse është një element i rëndësishëm i etikës, por e bën në mënyrë të drejtpërdrejt deklarimin për këtë pasuri të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të pikave 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

**10. Automjet tip “Citroen”, në vlerën 4,000 euro, me targa \*\*\*, në pronësi të bashkëshortes së subjektit.** Burimi i krijimit është nga pakësimi i gjendjes *cash* dhe të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2010.

**10.1** Në DIPP-në e vitit 2016 subjekti ka deklaruar shitjen e automjetit tip “Citroen”, në shumën 4,000 euro sipas deklaratës noteriale nr\*\*\*, datë 28.12.2016, ndërsa në DIPP-në e vitit 2010 ka deklaruar : *“... blerje autoveture tip ‘Citroen’, në shumën 5,000 euro ose në vlerën 694,050 lekë, në emër të bashkëshortes. Burim për këtë blerje: pakësim i gjendjes cash të deklaruar më parë; 2) të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2010”*.

**10.2** Komisioni ka kërkuar shpjegime nga subjekti për arsyen e mosndryshimit të pronësisë së automjetit nga bashkëshortja, për të cilin sqaron se: *“... automjeti tip ‘Citroen’, me targa \*\*\*, në pronësi të bashkëshortes sime është shitur në datën 28.12.2016. Ndërmjet bashkëshortes si shitëse dhe blerësit z. A. M. është nënshkruar deklarata noteriale e datës 28.12.2016, ku palët kanë deklaruar se automjeti është shitur kundrejt vlerës 4,000 euro, likuiduar në muajin shtator 2016. Me marrjen e certifikatës së pronësisë së mjetit, palët do të nënshkruajnë kontratën përfundimtare*

---

<sup>52</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 15.5.2006, për shitjen e automjetit tip “Volkswagen Golf”, me targa \*\*\* shtetas E. D., në vlerën 200,000 lekë.

<sup>53</sup>Kontratë shitblerjeje nr\*\*\*, datë 22.9.2005, në shumën 200,000 lekë, shitur shtetasit F. C. .

të shitjes. Në DIPP-në e vitit 2016 kam deklaruar shitjen e automjetit tip 'Citroen' në shumën 4,000 euro, referuar dokumentacionit të nënshkruar midis palëve.

Mbas pyetjes nga ana e Komisionit, mbi zotërimin ende në pronësi të automjetit në emër të bashkëshortes time, kam kontaktuar me blerësin, i cili më konfirmon faktin se nuk kishte kryer ende ndryshimin e pronësisë së mjetit. Bashkëshortja ime nuk e zotëron mjetin që prej muajit shtator 2016 dhe unë kam qenë i bindur se blerësi kishte ndryshuar pronësinë e mjetit. Pretendimi i blerësit për mosregjistrimin e mjetit në emrin e tij, ishte fakti se nuk ishte nënshkruar ende kontrata e shitjes përfundimtare. Fakt ky i papretenduar më parë nga blerësi. Për shkak se automjeti ishte në pronësi të bashkëshortes nuk kujtoja që prej saj nuk ishte firmosur ende kontrata e shitjes dhe se automjeti ishte ende në pronësi të saj. Palët kanë nënshkruar kontratën e shitjes së automjetit nr. \*\*\*, datë 20.1.2021. Si përfundim, mosdeklarimi i pasurisë në deklaratën Vetting është për arsyen se mjeti është deklaruar i shitur në DIPP-në e vitit 2016 dhe nuk disponohet prej bashkëshortes sime që prej shtatorit të vitit 2016”.

**10.3** Nga hetimi, referuar faqes zyrtare të AMF-së, rezulton se për automjetin tip “Citroen”, me targa \*\*\* është prerë policë sigurimi me status “pronar” për bashkëshorten e subjektit, për periudhën 29.8.2014 – 21.11.2021. Në periudhën 20.11.2010 – 21.11.2021 rezulton se znj. A. K. është e vetmja policëmbajtëse me status “përdorues” dhe “pronar”. Shtetasit A. dhe M. M. rezultojnë me status përdoruesi për periudhën 13.11.2017 – 13.12.2018.

**10.4** Në analizë të burimit të ligjshëm është hartuar analiza financiare deri në datën e blerjes së automjetit, e cila është paraqitur në tabelën vijuese:

<b>Periudha</b>	<b>1.1- 1.7.2010</b> (vlera në lekë)
Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit	566 183
Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit	172 374
Shpenzime për kredinë e marrë në BKT	336 946
Shpenzime jetese	341 550
Blerja e automjetit tip “Golf”, me targa *** (konsideruar vetëm diferenca nga çmimi me pakësimin e gjendjes <i>cash</i> )	494 050
Likuiditet në bankë	45 041 lekë
<b>Rezultati i analizës financiare</b>	<b>(479 030 lekë)</b>

**10.5** Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, pasi rezultoi me pamundësi financiare në vlerën 479,030 lekë për të krijuar pasurinë e mësipërme me të ardhura të ligjshme.

**10.6** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti shpjegoi se: “... në lidhje me analizën financiare për blerjen e automjetit tip 'Citroen', në shumën 5,000 euro ose në vlerën 694,050 leke, sqaroj se Komisioni e ka përlllogaritur në mënyrë të gabuar. Pakësimi i gjendjes *cash* në shumën 200,000 lekë është në fund të vitit 2010 dhe jo në datën 1.7.2010. Në analizën financiare duhet të konsiderohet

*pakësimi i gjendjes në vlerën 1,700,000 lekë, që në fund të vitit ka arritur të jetë 1,500,000 lekë, duke rezultuar me një pakësim në shumën 200,000 lekë”.*

**10.7** Komisioni, mbështetur në praktikën e tij, çmon se do të konsiderohej si burim gjendja *cash* në vitin paraardhës (31.12.2009) vetëm nëse subjekti do ta kishte deklaruar pakësimin e saj me qëllim blerjen e automjetit më sipër në deklaratën përkatëse vjetore. Në këto kushte, nuk konsiderohet burim për krijimin e pasurisë gjendja *cash* e vitit 2009, pasi nuk është deklaruar në DIPP-në e vitit 2009 se ka qenë burim për blerjen e automjetit.

**10.8** Për sa më sipër, për këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të pikave 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

## **11. Të ardhurat e deklaruar**

### **11.1** Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit:

a) Nga paga si prokuror pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Has, për periudhën 1.8.1992 – 30.3.1995. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara rezulton në vlerën 311,520 lekë.

Subjekti ka përcjellë me deklaratën *Vetting* vërtetimin<sup>54</sup> e lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, ku konfirmohet se për periudhën 1.8.1992 – 30.3.1995, të ardhurat nga paga janë në shumën totale 311,520 lekë.

b) Nga paga si drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë për periudhën 1.4.1995 – 28.10.1997. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara 694,524 lekë. Të ardhura nga paga si prokuror për periudhën nëntor 1997 – 31.10.1998. Rikthyer në detyrë në periudhën 27.12.2001 - 10.6.2008. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara 5,491,208 lekë.

Subjekti ka përcjellë me deklaratën *Vetting* vërtetimin<sup>55</sup> e lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, ku konfirmohet se për periudhën nëntor 1997 - 10.6.2008, të ardhurat nga paga janë në shumën 5,491,208 lekë.

c) Nga paga si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për periudhën 11.6.2008 – 7.10.2010. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara 2,428,656 lekë.

Subjekti ka përcjellë me deklaratën *Vetting* vërtetimin<sup>56</sup> e lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku konfirmohet se për periudhën 11.6.2008 – 7.10.2010, të ardhurat nga paga janë në shumën totale 2,428,656 lekë.

d) Nga paga si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën tetor 2010 – dhjetor 2016. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara 7,505,011 lekë.

---

<sup>54</sup>Shihni vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2016.

<sup>55</sup>Shihni vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2016.

<sup>56</sup>Shihni vërtetimin nr\*\*\*prot., datë 24.10.2016.

Subjekti ka përcjellë me deklaratën *Vetting* vërtetim<sup>57</sup> e lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku konfirmohet se për periudhën tetor 2010 – dhjetor 2016, të ardhurat nga paga janë në shumën totale 7,505,011 lekë.

e) Të ardhura të përfituara nga vendimi nr. \*\*\*, datë 20.11.2001, “Për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit”, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vërtetuar dhe nga vërtetimi me nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2016, i lëshuar nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Prokuroria e Përgjithshme. Shuma e të ardhurave *neto* të krijuara 1,351,043 lekë.

**11.2** Në analizën financiare të përcjellë me rezultatet e hetimit janë përfshirë të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit sipas vlerave të konfirmuara nga DPT-ja, ISSH-ja dhe shkresat e institucioneve bankare, të cilat përputhen me vlerat e vërtetimeve të institucioneve të përcjella nga subjekti.

**11.3** Të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit:

a) Nga puna si financiere pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 1.5.2002 – 1.3.2008, në shumën 816,817 lekë dhe të ardhura nga puna pranë kësaj shoqërie në shumën 300,000 lekë për nxjerrjen e bilancit, viti 2009.

Subjekti ka përcjellë me deklaratën *Vetting* vërtetimin<sup>58</sup> e lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në lidhje me të ardhurat për periudhën 1.5.2002 – 1.3.2008, në shumën *neto* totale 816,817 lekë dhe vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2010, lëshuar nga kjo shoqëri. Të ardhurat nga puna me kohë të pjesshme për vitin 2009, në shumën 300,000 lekë.

b) Nga puna me kohë të pjesshme në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, në shumën 280,000 lekë për nxjerrjen e bilancit dhe pasqyrave financiare të vitit 2009.

Subjekti ka përcjellë me deklaratën *Vetting* vërtetimin<sup>59</sup> e lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ku konfirmohet se të ardhurat nga puna me kohë të pjesshme për vitin 2009 janë në shumën 280,000 lekë.

c) Nga puna me kohë të pjesshme në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., në shumën 100,000 lekë për nxjerrjen e bilancit, viti 2009.

Subjekti ka përcjellë me deklaratën *Vetting* vërtetim<sup>60</sup> e lëshuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ku konfirmohet se të ardhurat nga puna me kohë të pjesshme për vitin 2009 janë në shumën 100,000 lekë.

**11.3.1** Në lidhje me të ardhurat e paraqitura në geramat (a) deri në (c) nuk është përcjellë informacion për kryerjen e pagesës së tyre nga ISSH-ja<sup>61</sup> dhe DPT-ja. Gjithashtu, nuk rezultojnë as në të dhënat bankare të bashkëshortes pagesat e mësipërme.

<sup>57</sup>Shihni vërtetimin datë 20.1.2017.

<sup>58</sup>Shihni aneksin nr. 38, dosja ILDKPKI.

<sup>59</sup>Shihni aneksin nr. 38, dosja ILDKPKI.

<sup>60</sup>Shihni aneksin nr. 38, dosja ILDKPKI.

<sup>61</sup>Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., nga ISSH-ja dhe nr. \*\*\* prot., nga DTR-ja.

**11.3.2** Komisioni ka kërkuar nga subjekti<sup>62</sup> përcjelljen e provave për pagesat e marra nga bashkëshortja e tij. Gjatë hetimit subjekti sqaron se: “... referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, në nenin 33 të tij është përcaktuar se tatimpaguesi për pagesat e kryera individëve është i detyruar të shërbejë si agjent i tatimit në burim. Agjenti i tatimit në burim përkufizohet si personi i tatueshëm i cili duhet të llogarisë, të mbajë dhe të derdhë në buxhetin e shtetit shumën e tatimit në burim. Ky detyrim që i jep ligji nuk është zbatuar nga këto tre kompani për shërbimet që bashkëshortja ime ka kryer. Ndonëse në vërtetimet dhe kthim përgjigjet përkatëse ata kanë konfirmuar përfitimin, por kanë shprehur edhe faktin se pagesa e detyrimit për tatimin në burim nuk është bërë. I kam kërkuar ose të përmbushin detyrimin tatimor ose do të ndiqja rrugën ligjore me qëllim detyrimin për pagesë të tatimit në burim. Nga këto kompani është kryer një pagesë, e cila duhej tatuar. Marrëveshja ndërmjet tyre ka qenë mbi vlerën neto të rënë dakord dhe tatimi në burim do të llogaritej mbi këtë masë përfitimi. Kam kërkuar të gjej pranë këtyre shoqërive edhe mandatet ku bashkëshortja ime ka firmosur në momentin e pagesës. Për shkak të kohës së largët që ka kaluar, ndryshimit të ekonomistëve nuk kam arritur t’i siguroj këto mandate. Por ashtu siç kam paraqitur në vitin përkatës vërtetimin ashtu edhe bashkëshortja ka firmosur për efekt dokumentacioni edhe mandatpagesën”.

Subjekti ka përcjellë me përgjigjet e pyetësorit urdhërpagesat e tatimit në burim të shoqërive “\*\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*\*” sh.p.k., ku është përmbushur detyrimi tatimor në prill të vitit 2020.

**11.3.3** Gjithashtu, i pyetur gjatë hetimit për të ardhurat e bashkëshortes nga puna si financiere në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 1.5.2002 – 1.3.2008, në vlerën totale 816,817 lekë ka shpjeguar<sup>63</sup>: “... bashkëshortja ime ka punuar në subjektin ‘\*\*\*’ sh.p.k. nga data 1.5.2002 deri më 1.3.2008. Deklarimi për të punësuarit rishtazi në datën 1.5.2002 është bërë me të dhënat A. S., pasi në këtë datë unë nuk kisha lidhur martesë ligjore me bashkëshorten. Referuar certifikatës së martesës, unë kam lidhur martesë ligjore në datën 2.7.2002. Të gjitha listëpagesat duke filluar nga ajo e muajit maj 2002 dhe në vazhdim janë deklaruar me të dhënat A. S. dhe numër sigurimi \*\*\*. Për të vërtetuar këtë fakt po ju vendos në dispozicion: listën e ndryshimit të fuqisë punëtore të datës 14.4.2008, ku vërtetohet fakti se është larguar punonjësi A. C. S., me profesion ekonomiste dhe datë largimi nga puna 1.3.2008; listëpagesë e muajit shkurt 2008, sigluar nga inspektori i DRIT-së në datën 13.3.2008; listëpagesë e muajit janar 2007, sigluar nga inspektori i DRIT-së në datën 13.2.2007; listëpagesë e muajit mars 2007, sigluar nga inspektori i DRIT-së në datën 13.4.2007; listëpagesë e muajit qershor 2007, sigluar nga inspektori i DRIT-së në datën 13.7.2007; listëpagesë e muajit gusht 2007, sigluar nga inspektori i DRIT-së në datën 14.9.2007.

Vlerësoj se është pikërisht deklarimi me mbiemrin e vajzërisë në listëpagesat mujore, fakti se nuk ju ka rezultuar e provuar pagesa e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat personale. Sqaroj se jemi drejtuar me kërkesë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore për pajisjen me vërtetim për bazën e vlerësuar të pagës në këtë periudhë. Me marrjen e përgjigjes do e vendosim menjëherë në dispozicion të Komisionit”.

<sup>62</sup>Shihni pyetësorin nr. 2 vazhdimi.

<sup>63</sup>Shihni përgjigjen e pyetësorit nr. 3, pyetja 4.

**11.3.4** Komisioni, në vijim, i është drejtuar ISSH-së duke përsëritur kërkesën dhe bashkëlidhur listëpagesat e përcjella nga subjekti si provë, por me mbiemrin para martesë të znj. A.K. (S.) (S.). ISSH-ja<sup>64</sup> konfirmon se për shtetasen A.S. (S.) disponojnë të dhënat të nxjerra nga sistemi informatik i ISSH-së, i cili ka të dhëna për kontributet, të cilat dërgohen nga DPT-ja nëpërmjet *ëbservice*, bashkëlidhur me shkresën, të njëjtën përgjigje të dërguar më herët nga kërkitori për znj. A. K. . Gjithashtu, ISSH-ja përcjell edhe shkresën drejtuar prej tyre për kërkesë informacioni ISSH-së Lundër.

**11.3.5** Të ardhurat e përfituara pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 2002 – 2008, nuk janë përfshirë në analizën financiare, deri në këto momente, sepse nuk provohet pagesa e vlerave të tyre dhe e detyrimeve tatimore. Ndërsa për të ardhurat e tjera të paraqitura në geramat (a)-(c) më sipër, detyrimet tatimore janë shlyer në prill të vitit 2020 dhe jo në momentin e përfitimit të tyre. Të ardhurat e mësipërme nuk u përfshinë në rezultatet e hetimit të Komisionit.

**11.4** Të ardhurat e bashkëshortes: nga puna si punonjëse pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale Qyteti Tiranë, me detyrë specialiste e pagave në Sektorin e Shërbimeve të Përgjithshme, në shumën 2,811,191 lekë; nga puna si punonjëse pranë ILDKPKI-së, me detyrë specialiste buxheti, në sektorin e Financë-Buxhetit dhe Administrimit, në shumën 1,143,255 lekë; dhe nga raporti i paguar nga drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë për periudhën 1.10.2009 -23.10.2010, në shumën 252,133 lekë. Subjekti ka përcjellë me deklaratën *Vetting* vërtetimin<sup>65</sup> e lëshuar nga DAR Tiranë, ku konfirmohen të ardhurat për periudhën 3.4.2008 – 5.5.2015, në shumën 2,811,607 lekë, vërtetimin<sup>66</sup> e lëshuar nga ISSH-ja, ku konfirmohen të ardhurat nga barrëlidhja për periudhën 1.10.2009 – 23.10.2010, në shumën 252,133 lekë dhe vërtetimet nga ILDKPKI-ja nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2016, ku konfirmohen të ardhurat për periudhën 6.5.2015 – 31.12.2016, me vlerë 1,143,255 lekë.

Për të ardhurat e mësipërme, deklarimi i bashkëshortes përputhet me të dhënat e përcjella në Komision.<sup>67</sup> Të ardhurat e mësipërme janë përfshirë në analizën financiare të Komisionit.

**11.5** Pas dërgimit të barrës së provës, në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., subjekti përcjell në Komision vërtetim për bazën e vlerësueshme lëshuar nga Agjencia në Kavajë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për periudhën 2002 – 2008. Komisioni çmon se dokumentet e përcjella nga subjekti pas kalimit të barrës së provës për të provuar të ardhurat e bashkëshortes në periudhën 2002 – 2008<sup>68</sup> janë shteruese dhe përfshirja e tyre në analizën financiare do ta ndikojë, duke ulur vlerën negative prej 14,065,289 lekësh, e cila është dërguar me rezultate hetimi në vlerën 13,387,955 lekë.

<sup>64</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2021.

<sup>65</sup>Shihni vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2016, lëshuar nga ISSH-ja.

<sup>66</sup>Shihni vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2016.

<sup>67</sup>Shihni shkresat nr. \*\*\*prot., nga ISSH-ja dhe nr. \*\*\*prot., nga DTR-ja.

<sup>68</sup>Të ardhurat e bashkëshortes për periudhën 2002 – 2008 (total 816,817 lekë).

**11.5.1** Ndërsa në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes pranë shoqërive “\*\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., për të cilat detyrimi tatimor është shlyer në prill të vitit 2020, subjekti shpjegon se duhen konsideruar të ardhurat duke u bazuar në:

Së pari – të ardhurat janë të ligjshme sepse burojnë nga një burim i ligjshëm i përcaktuar i tillë në ligjin për tatimin mbi të ardhurat, në pikën 19, të nenit 13, të ligjit nr. 84/2016, legjislationin e parashikuar në Aneksin e Kushtetutës si dhe në ligjin nr. 84/2016 konceptimin e “dyfishi i pasurisë së ligjshme”.

Së dyti – detyrimi për pagimin e detyrimeve tatimore ka qenë i tatimpaguesve dhe jo i subjektit të rivlerësimit.

Së treti – praktika e organeve të rivlerësimit në lidhje me qëndrimin e ndryshëm për pagesën e detyrimeve tatimore me vonesë, në të cilën citon disa vendime të marra nga Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit<sup>69</sup>.

**11.5.2** Komisioni çmoi se shpjegimet e subjektit, pas kalimit të barrës së provës për të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja e tij në shoqëritë “\*\*\*\*” sh.p.k., “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., nuk janë shteruese dhe nuk i konsideroi gjatë hartimit të analizës financiare të viteve 2003 – 2016.

**11.6 Në përfundim të hetimit, analiza financiare<sup>70</sup>, për periudhën 2003 – 2016, përcjellë me rezultatet e hetimit, rezultoi me vlerë negative 14,065,289 lekë. Ndërsa pas kalimit të barrës së provës dhe përcjelljes së provave/shpjegimeve nga subjekti vlera e saj rezulton me vlerë negative prej 13,291,390 lekësh.**

Në vijim, tabela ku pasqyrohet analiza financiare.

---

<sup>69</sup>Vendimet: nr. 56, datë 1.8.2018; nr. 212/2019; nr. 161, datë 18.6.2019; nr. 162, datë 19.6.2019; nr. 241, datë 26.2.2020; vendimi nr. 05, datë 13.03.2020, i Kolegjit.

<sup>70</sup>Metodologjia e analizës financiare është pjesë e dosjes së Komisionit dhe subjekti i rivlerësimit është njohur me të.



Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	0	200 000	1 336 141	722 704	7 365 554	7 526 317	7 277 711	459 968	735 864	-129 127	52 892	69 047	828 205	-66 809
Apartament në rrugën "T.T****" me sip. 135.5 m <sup>2</sup>					6 650 050	8 963 991								
Shtëpi banimi 110 m <sup>2</sup> , ndërtuar në 2001, rruge "S.K *****" T***					-6 900 000									
Trrall me sipërfaqe 398.9 m <sup>2</sup> (1/5 pjesë) përfunduar me trashëgimi nga babai														
Apartament me sip. 80.5 m <sup>2</sup> , L**** (në bashkëpronësi) 1/5														
Autoveture tip O*** Z*** me targa T*****			250 000											
Autoveturë W***** G***, me targë T*****		200 000												
Autoveturë tip B****, me targë T***** (A****)														
Autoveturë "C*****" me targë A**** (ose T****) në emër të bashkëshortes								694 050						
Autonjet tip W***** me targë A**** në pronësi të bashkëshortes													200 000	
Shtesa pakësimi likuiditete CASH dhe bankë	0	0	1 086 141	722 704	715 504	-1 437 674	727 711	-234 082	735 864	-129 127	52 892	69 047	628 205	-66 809
Gjendje e kursimeve (cash) sipas deklarimeve	0	0	900 000	1 700 000	2 400 000	1 000 000	1 700 000	1 500 000	2 000 000	2 000 000	2 000 000	2 000 000	2 500 000	2 500 000
<i>Total likuiditete</i>	0	0	1 086 141	1 808 846	2 524 350	1 086 676	1 814 387	1 580 305	2 316 169	2 187 042	2 239 934	2 308 981	2 937 186	2 870 377
<b>DETYRIME</b>	0	0	0	0	0	4 152 103	-350 745	-402 220	-396 397	-429 990	-493 740	-536 146	-599 243	-565 613
Kredi për blerje shtëpie në B*** sha në vitin 2008, në shumën 35.000 €						4 152 103	-350 745	-402 220	-396 397	-429 990	-493 740	-536 146	-599 243	-565 613
<b>PASURI NETO</b>	0	200 000	1 336 141	722 704	7 365 554	3 374 214	1 078 456	862 188	1 132 261	300 863	546 631	605 193	1 427 448	498 804
<b>TË ARDHURA dokumentuar</b>	786 883	978 891	1 186 966	1 140 336	1 509 223	1 121 635	1 453 426	1 477 113	1 621 444	1 504 446	1 561 024	1 859 282	1 925 163	2 526 911
Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit	609 500	895 586	862 689	952 968	869 463	781 786	1 137 450	1 132 366	1 156 421	1 066 756	1 070 996	1 341 858	1 322 071	1 294 897
Të ardhura nga paga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit	77 383	83 305	124 277	187 368	239 760	339 849	315 976	344 747	465 023	437 690	490 028	517 424	603 092	690 934
Të ardhurat nga vendimi gjyqësor dhe shkresa e Prokurorisë së Përgjithshme														
Të ardhura nga apartamenti në qytetin e K**** në bashkëpronësi	100 000													
Të ardhura nga shitja e autonjetit W*****, i blerë në 2004 dhe i shitur në 2005			200 000											
Të ardhura nga shitja e autonjetit tip O*** Z**** me targa T****					200 000									
Të ardhura nga shitja e autonjetit tip B****, me targë T**** (A****)					200 000									
Të ardhura nga shitja e autonjetit C** me targë A** (ose T**) në emër të bashkëshortes														541 080
Të ardhura nga shitja e autonjetit W***** me targë A**** në pronësi të bashkëshortes													1 376 500	
<b>SHPENZIME</b>	281 592	375 456	438 228	438 228	492 354	1 090 589	1 121 744	951 259	912 941	929 086	953 386	1 486 520	1 723 607	2 054 456
Shpenzime për shlyerjen e kredisë të marrë në B** për blerje shtëpie në vitin 2008						188 899	331 785	268 159	216 011	175 064	161 256	102 464	67 815	45 447
Shpenzime jetese	281 592	375 456	438 228	438 228	492 354	546 480	683 100	683 100	683 100	705 120	705 120	1 099 990	1 121 380	1 175 460
Shpenzime për rregullimin e makinës të blerë në vitin 2015													300 000	
Shpenzime shkolli për fëmijet në shkollë jo-publike											80 000	200 000	200 000	661 080
Shpenzime udhëtimi					155 210	6 859	-	13 830	48 902	7 011	84 066	34 413	142 710	
Shpenzime për kontrolle shëndetësore në B***														29 759
Shpenzime mobilimi, arredimi dhe ndërtimi						200 000	100 000							
<b>Analiza dokumentuar</b>	505 291	403 435	-587 403	-20 596	-6 348 685	-3 343 168	-746 774	-336 334	-423 757	274 498	61 007	-232 431	-1 225 892	-26 349

## **Konkluzion i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e administruar, përgjigjet dhe provat e paraqitura nga subjekti për pyetësorët e dërguar, si dhe provat dhe parashtrimet në përgjigje të barrës së provës, vlerëson se:

Në përfundim, siç është konstatuar dhe më sipër, subjekti/personat e lidhur me të: (i) nuk kanë deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë burimet që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë apartament në Tiranë; (ii) nuk kanë deklaruar burime të ligjshme për krijimin e pasurisë apartament në Tiranë; (iii) nuk kanë deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë pasurinë e ndodhur në katin e tretë në rrugën “\*\*\*”, duke mosdeklaruar pjesën takuese të saj; (iv) nuk kanë deklaruar burime të ligjshme për krijimin e pasurisë, të ndodhur në katin e tretë në rrugën “\*\*\*”; (v) nuk kanë deklaruar në mënyrë të plotë dhe të saktë transaksionet me automjete, pasuri të krijuara gjatë periudhës së rivlerësimit; (vi) nuk kanë pasur mundësi të krijojnë likuiditet dhe të kryejnë shpenzimet duke rezultuar me një pamundësi financiare në vlerën 13,291,390 lekë.

### **Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se:**

- i. Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Subjekti nuk ka justifikuar me burime të ligjshme blerjen e pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të tij apo të personave të lidhur me të, në kuptim të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Subjekti nuk paraqiti prova, si dhe nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe pasurive të tij sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Komisioni mban parasysht në vlerësimin e tij qëndrimin jobashkëpunues të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur në kohë pyetësorëve të dërguar, por përgjigjet e tij nuk kanë qenë shteruese. Subjekti ka tentuar zvarritje të procesit, duke depozituar kërkesa të njëpasnjëshme, të cilat synonin pezullim të procesit të rivlerësimit.

## **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura prej tij, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, mbështetur në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundim se subjekti i rivlerësimit, nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Avni Kraja, prokuror në Prokurorinë e pranë Gjykatë së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 18.5.2021.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Lulzim HAMITAJ**  
Kryesues

**Alma FASKAJ**  
Relatore

**Genta TAFA (BUNGO)**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Denisa Kosta*